

RAPORTI PËR TË DREJTAT THEMELORE – 2023

Viti 2022 solli njëkohësisht progres dhe pengesa në fushën e mbrojtjes së të drejtave themelore. Agjencia e Bashkimit Evropian (FRA) në *Raportin për të drejtat themelore të vitit 2023* merr në shqyrtim zhvillimet më të mëdha në këtë fushë, duke identifikuar arritjet dhe fushat ku ka ende vend për shqetësim. Ky botim paraqet opinionet e FRA-së për zhvillimet kryesore në fushat tematike që mbulon raporti dhe një përmbledhje të provave mbi të cilat mbështeten këto opinione. Kështu, raporti jep një pamje të përgjithshme të thukët por informuese të sfidave kryesore të të drejtave themelore me të cilat përballen BE-ja dhe Shtetet e saj Anëtare.

OPINIONET E FRA-SË

1 [FOKUS]

Pasojat e luftës në Ukrainë për të drejtat themelore të BE-së

4

Zbatimi dhe përdorimi i Kartës në nivel kombëtar

7

Barazia dhe mosdiskriminimi

10

Racizmi, ksenofobia dhe intoleranca e lidhur me to

13

Barazia dhe përfshirja e romëve

17

Azili, vizat, migracioni, kufijtë dhe integrimi

19

Shoqëria e informacionit, privatësia dhe mbrojtja e të dhënave

22

Të drejtat e fëmijës

25

Qasja te drejtësia: të drejtat e viktimave dhe pavarësia e gjyqësorit

27

Zhvillimet në zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar



Dorëshkrimi u përfundua në prill 2023.

As Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, as ndonjë person që vepron për llogari të Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore nuk janë përgjegjës për përdorimin që mund t'u bëhet informacioneve të mëposhtme.

Luksemburg: Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian, 2023

Print	ISBN 978-92-9489-232-4	doi:10.2811/674590	TK-AM-23-001-SQ-C
PDF	ISBN 978-92-9489-231-7	doi:10.2811/90551	TK-AM-23-001-SQ-N

© Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, 2023

Riprodhimi autorizohet me kushtin që të përmendet burimi.

Për përdorimin ose riprodhimin e fotografive apo materialeve të tjera të cilat nuk përfshihen në të drejtat e autorit të Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, duhet të merret leje drejtpërdrejt te zotëruarit të drejtave të autorit.

Burimi ku janë marrë fotografitë:

Ballina: Insta_photos/iStock; Gorodenkoff/iStock; Louis Gouliamaki/AFP nëpërmjet Getty Images

Faqe 1: © Louis Gouliamaki/AFP nëpërmjet Getty Images

Faqe 2: © Katya Moskalyuk/Global Images Ukraine nëpërmjet Getty Images

Faqe 3: © Hatim Kaghat/BELGA MAG/AFP nëpërmjet Getty Images

Faqe 4: © European Communities

Faqe 4: © Monkey Business/Adobe Stock

Faqe 6: © Hunterframe/Adobe Stock

Faqe 7: © Maskot/Getty RF

Faqe 9: © Valentinrussanov/iStock

Faqe 10: © CarlosBarquero/Adobe Stock

Faqe 11: © Attila Kisbenedek/AFP nëpërmjet Getty Images

Faqe 12: © Markus Scholz/picture alliance nëpërmjet Getty Images

Faqe 13: © Serhii Hudak/Ukrinform/Future Publishing nëpërmjet Getty Images

Faqe 15: © Attila Kisbenedek/AFP nëpërmjet Getty Images

Faqe 16: © El Medina/AFP nëpërmjet Getty Images

Faqe 17: © Eric Lalmand/BELGA MAG/AFP nëpërmjet Getty Images

Faqe 18: © Jens Büttner/picture alliance nëpërmjet Getty Images

Faqe 19: © Gorodenkoff/iStock

Faqe 20: © DC Studio/Adobe Stock

Faqe 21: © Peter Cade/Getty RF

Faqe 22: © Dominika Zarzycka/SOPA Images/LightRocket nëpërmjet Getty Images

Faqe 23: © Javier Fergo/picture alliance nëpërmjet Getty Images

Faqe 24: © Stock Rocket/Adobe Stock

Faqe 25: © Jan Woitas/picture alliance nëpërmjet Getty Images

Faqe 26: © Uli Deck/picture alliance nëpërmjet Getty Images

Faqe 27: © Halfpoint/iStock

Faqe 28: © insta_photos/iStock

PASOJAT E LUFTËS NË UKRAINË PËR TË DREJTAT THEMELORE TË BE-SË

Lufta e paprovokuar e Rusisë kundër Ukrainës ka shkaktuar zhvendosje masive të brendshme dhe të jashtme të popullatës. Afërsisht 8 milionë njerëz të ikur nga Ukraina mbërritën në Evropë. Rreth 4 milionë prej tyre kanë marrë mbrojtje të përkohshme në BE. Kjo zhvendosje vuri në lëvizje një valë të stërmadhe mbështetjeje dhe solidariteti nga qeveritë, autoritetet vendore dhe nga shoqëria si një e tërë.

BE-ja aktivizoi për herë të parë Direktivën “Për mbrojtjen e përkohshme” që prej miratimit të saj në vitin 2001. Në rast fluksesh masive dhe pamundësie për t’u rikthyer, direktiva u jep të drejtë personave të zhvendosur për shkak të luftës të kenë leje qëndrimi të ligjshme dhe qasje në punësim, strehim, asistencë sociale, arsim dhe kujdes shëndetësor. Duke qenë se shumica dërrmuese e personave të ikur nga Ukraina janë gra – shumë prej tyre me përgjegjësi për t’u kujdesur për fëmijët dhe/ose të moshuarit – dhënia e qasjes në shërbime specifike nevojitet të jetë e përshtatur dhe specifike për gjininë. Shërbimet duhet gjithashtu të përfshijnë mbështetjen për ato që kanë përjetuar dhunë dhe shfrytëzim seksual.

Agjencia e BE-së për të Drejtat Themelore (FRA) nisi një sërë veprimtarish për të identifikuar sfidat dhe për të propozuar zgjidhje për të gjitha aspektet e mbuluara nga Direktiva “Për mbrojtjen e përkohshme” dhe nga legjislati i BE-së për trafikimin e qenieve njerëzore, krimet nga urrejtja dhe për të drejtat e viktimave të krimit, të cilat në tërësi zbatohen për përfituesit e mbrojtjes së përkohshme.

Sipas parashikimeve të nenit 13 të Direktivës “Për mbrojtjen e përkohshme”, përfituesit e mbrojtjes së përkohshme – pjesa më e madhe e të cilëve janë gra dhe fëmijë – duhet të kenë qasje në strehim të përshtatshëm ose, nëse është e nevojshme, t’u jepen mjetet për të përfituar strehim. Përveç kësaj, Karta e BE-së për të Drejtat Themelore (Karta) mbron të drejtën e asistencës për strehim, për të garantuar një ekzistencë dinjitoze për të gjithë ata që nuk kanë burime të mjaftueshme (neni 34).

Megjithatë, në mjaft Shtete Anëtare ka ende pengesa për ofrimin e një strehimi të përshtatshëm dhe të sigurt. Sidomos ka vështirësi në sistemimin afatgjatë, në sigurimin e qasjes në asistencën për strehim dhe në verifikimin sistematik të ofruesve privatë të strehimit. Gjetjet e anketës së FRA-së gjatë vitit 2022 *Të ikësh nga Ukraina* pohojnë këto të dhëna: gjashtë nga 10 të anketuar, në momentin e anketës, qëndronin në apartamente ose shtëpi private. Probleme të tjera të shprehura ishin mungesa e privatësisë (e vënë re nga 36 % e të anketuarve) dhe mungesa e një dhome të qetë/të veçantë ku të studiojnë fëmijët (e vënë re nga 23 % e të anketuarve). Përveç kësaj, më shumë se gjysmës së të anketuarve i është dashur të paguajë strehimin tërësisht ose pjesërisht vetë.



OPINIONI 1.1 I FRA-SË

Nisur nga nevojat e veçanta të personave të zhvendosur që i kanë ikur pushtimit rus në Ukrainë, Shtetet Anëtare të BE-së duhet që ta kenë përparësi, aty ku është e mundur, gjetjen e strehimit të përshtatshëm në përputhje me qëllime afatgjata. Shtetet Anëtare të BE-së duhet të verifikojnë që strehimi në banesa private të jetë i përbalueshëm, i sigurt dhe i përshtatshëm, sidomos për gra dhe fëmijë. Personat që ofrojnë strehim duhet të marrin njëfarë forme kompensimi financiar ose kompensim të një lloji tjetër.

Zgjidhjet e suksesshme për strehimin e personave të zhvendosur nga Ukraina duhet të shërbejnë edhe si bazë për strategjitë afatgjata për të trajtuar mangësitë në strehimin e azilkërkuesve në një shkallë më të përgjithshme në mjaft Shtete Anëtare. Orientimet dhe mbështetja e dhënë nga agjencitë përkatëse të BE-së, si FRA-ja dhe Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA), mund të shërbejnë për zbatimin e masave të tilla në mënyrë të tillë që të respektohen të drejtat themelore.

OPINIONI 1.2 I FRA-SË

Shtetet Anëtare duhet gjithashtu të ndihmojnë përfituesit e mbrojtjes së përkohshme të gjejnë punë, të punëdhënësit e regjistruar, në përputhje me kualifikimet dhe aftësitë e tyre. Kjo gjë mund të bëhet duke nxitur më tej nismën "EU Talent Pool Pilot", e krijuar nga Rrjeti Evropian i Bashkëpunimit të Shërbimeve të Punësimit (EURES) nën drejtimin e Autoritetit Evropian të Punës (ELA). Kjo nismë pilote ndihmon përputhjen e aftësive të përfituesve të mbrojtjes së përkohshme me punëdhënësit e regjistruar. Për të mbrojtur personat e zhvendosur nga rreziku i shfrytëzimit në punë, ELA-ja dhe inspektoratet e punës së Shteteve Anëtare duhet forcojnë dhe intensifikojnë bashkëpunimin e tyre, edhe nëpërmjet inspektimeve të përbashkëta në sektorët me rrezik të lartë. Inspektimet e punës duhet të zbatohen për të përmirësuar dhënien e informacionit dhe si mundësi për rritjen e ndërgjegjësimit, bashkë me veprimet për monitorimin dhe zbatimin të ligjit në kushtet e punës.

OPINIONI 1.3 I FRA-SË

Shtetet Anëtare të BE-së duhet të rritin përpjekjen për të garantuar që fëmijët e zhvendosur nga Ukraina të integrohen në shkollë dhe në strukturat e kujdesit për fëmijë sa më shpejt të jetë e mundur, duke marrë në konsideratën e duhur gjuhën dhe kulturën e tyre. Vëmendje e veçantë u duhet kushtuar fëmijëve me aftësi të kufizuara, sidomos atyre që jetojnë në struktura institucionale, për të siguruar që nevojat e tyre specifike për aksesueshmëri dhe mbështetje më të madhe të trajtohen në mënyrën e duhur. Ky integrim do të lehtësonte shoqërimin e tyre dhe do t'i jepte normalitet jetës së tyre të përditshme. Fondet e vendeve anëtare dhe ato të BE-së duhet të përdoren për të ofruar kurse gjuhe, për të rritur numrin e personelit dhe për të rritur kujdesin për fëmijët dhe kapacitetet e shkollave.

Në zbatim të nenit 12 të Direktivës "Për mbrojtjen e përkohshme", legjislacioni i përgjithshëm në Shtetet Anëtare që zbatohet për pagesën, qasjen në sistemet e sigurimeve shoqërore për personat e punësuar ose për veprimtaritë e vetëpunësimit duhet të zbatohet edhe për përfituesit e mbrojtjes së përkohshme. Nenet 1 dhe 31 të Kartës garantojnë të drejtat themelore të dinjitetit njerëzor dhe të kushteve të drejta dhe të barabarta në punë.

Megjithatë, në përgjithësi, dy të tretat e të anketuarve në anketën e FRA-së të vitit 2022 *Të ikësh nga Ukraina*, të moshës 16 vjeç e lart, nuk ishin të punësuar me pagesë në momentin e anketës. Ndër personat që ishin të punësuar me pagesë, 3 ndër 10 të anketuar kishin përjetuar një formë shfrytëzimi në punë. Kërkimet e mëparshme të FRA-së kanë konstatuar se këto shkelje nuk ndëshkohen në mënyrën e duhur dhe se Direktiva "Për sanksionet ndaj punëdhënësve" mbron vetëm migrantët në situatë të parregullt kundër shfrytëzimit të rëndë në marrëdhëniet e punës.

Sipas nenit 14 të Direktivës "Për mbrojtjen e përkohshme", Shtetet Anëtare të BE-së kanë detyrimin për t'u garantuar fëmijëve që gëzojnë mbrojtje të përkohshme qasje në arsim në të njëjtat kushte si shtetasve të tyre. Megjithatë, regjistrimi në shkollë i fëmijëve të zhvendosur nga Ukraina vazhdon të jetë i ulët për shkak të mungesës së hapësirës në shkollë, numrit të pamjaftueshëm të personelit ose për shkak të pengesave gjuhësore.

Siç e tregojnë gjetjet e anketës së FRA-së *Të ikësh nga Ukraina* të vitit 2022, pothuajse dy të tretat e fëmijëve të zhvendosur nga Ukraina ndjekin arsimin në internet të ofruar nga autoritetet ukrainase. Më shumë se një e katërta e personave të moshës 12-15 vjeç tha se arsyeja kryesore për mosvajtjen në shkollë ishte se nuk kishin një vend të qëndrueshëm për të jetuar dhe një e pesta tha se arsyeja kryesore ishte mospranimi në një shkollë.

Anketa e FRA-së *Të ikësh nga Ukraina* e vitit 2022 pohoi se mungesa e strukturave të kujdesit për fëmijët është gjithashtu një pengesë e rëndësishme për t'iu qasur punës, sidomos për gratë, të cilat përfaqësojnë shumicën e të rriturve të zhvendosur nga Ukraina.



Shumica dërrmuese e 4 milionë njerëzve që i kanë ikur pushtimit rus në Ukrainë, të regjistruar për mbrojtje të përkohshme ose në skema të ngjashme kombëtare mbrojtjeje në BE deri në fund të vitit, janë gra – shumë prej tyre kanë përgjegjësinë e kujdesjes për fëmijë dhe/ose persona të moshuar. Njëra prej pengesave kryesore për qasjen në punë – paralelisht me njohjen e pamjaftueshme të gjuhës së vendit pritës – është përgjegjësia për t'u kujdesur, sipas gjetjeve të anketës së FRA-së *Të ikësh nga Ukraina* në vitin 2022. E megjithatë, masat e marra nga Shtetet Anëtare të BE-së nuk kanë marrë parasysh në mënyrë të njëtrajtshme këtë perspektivë gjinore dhe nevojat e veçanta të grave të zhvendosura.

Në të gjithë BE-në u identifikuan edhe rreziqe për shfrytëzim seksual, ku u kallëzuan dhe hetuan një numër rastesh. Neni 20 (barazia para ligjit) dhe neni 21 (mosdiskriminimi) i Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore kërkojnë përpjekje të shtuara dhe veprime pozitive të shënjestruara nga autoritetet kombëtare për të siguruar qasje të barabartë dhe të përgjithshme në të gjitha të drejtat dhe shërbimet që ofron Direktiva "Për mbrojtjen e përkohshme" për të gjithë personat e zhvendosur që i kanë ikur luftës.



Sipas nenit 17 të Direktivës "Për mbrojtjen e përkohshme", vënia në veprim e skemës së mbrojtjes së përkohshme për personat e zhvendosur që i kanë ikur luftës kundër Ukrainës nuk i pengon këta persona që të ushtrojnë të drejtën e tyre për të kërkuar azil. Rreth një e treta e të anketuarve të anketës së FRA-së të vitit 2022 *Të ikësh nga Ukraina* kanë depozituar kërkesë për azil. Megjithatë, numri i personave që kanë kërkuar azil ndryshon nga një Shtet Anëtar në tjetrin.

Sipas parashikimeve të *acquis* së BE-së për azilin, personat që i largohen konfliktit dhe dhunës mund t'u kenë ikur këtyre situatave në disa rrethana dhe me disa karakteristika që i kualifikojnë ata si refugjatë ose përfitues të tjerë të mbrojtjes ndërkombëtare. Si deklamimi 12 ashtu edhe neni 3, paragrafi 5 i direktivës pohojnë se dhënia e mbrojtjes së përkohshme nuk prek të drejtën e posaçme të Shteteve Anëtare për të ofruar statuse më të favorshme mbrojtjeje.

Lufta e zgjatur dhe pamundësia e mëpasshme për kthimin e sigurt edhe pasi të ketë mbaruar lufta kërkon që Shtetet Anëtare të zbatojnë zgjidhje të qëndrueshme, të cilat të mbrojnë personat e zhvendosur pasi të ketë skaduar afati i zgjatur i mbrojtjes së përkohshme. Nëse nuk zbatohen zgjidhje të tilla, personat e zhvendosur rrezikojnë të përfundojnë në një gjendje pasigurie dhe pa perspektiva integrimi të vetëmjaftueshme në Shtetet Anëtare pritëse.

OPINIONI 1.4 I FRA-SË

Duke qenë se shumica e personave të ikur nga Ukraina janë gra – shumë prej tyre me përgjegjësi për t'u kujdesur për fëmijët dhe/ose të moshuarit – dhënia e qasjes në shërbime specifike nevojitet të jetë e përshtatur me gjininë dhe specifike. Shërbimet duhet gjithashtu të përfshijnë mbështetjen për ato që kanë përjetuar dhunë dhe shfrytëzim seksual. Edhe pse Direktiva "Për mbrojtjen e përkohshme" është hartuar në mënyrë asnjësore sa i takon gjinisë, zbatimi i dispozitave të saj nga Shtetet Anëtare të BE-së për qasjen në strehim, punësim, arsim, kujdes shëndetësor dhe mbrojtje sociale nuk duhet të bëhet verbërisht kur vjen puna te gjinia. Në përpjekjet e tyre në këtë aspekt, Shtetet Anëtare duhet të marrin në konsideratë të kërkojnë mbështetjen e agjencive përkatëse të BE-së si Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) dhe FRA-ja.

OPINIONI 1.5 I FRA-SË

Pasi të ketë përfunduar skema e BE-së për mbrojtjen e përkohshme, Shtetet Anëtare duhet të garantojnë që të mobilizohen mjete juridike kuptimplote për të ofruar në mënyrë të qëndrueshme një kalim të qetë nga statusi i mbrojtjes së përkohshme në statuse të tjera mbrojtjeje, qoftë në kuadrin ligjor të BE-së qoftë në kuadrin e legjislacionit kombëtar. Përdorimi i këtyre statuseve të qëndrueshme të mbrojtjes, ku hyjnë edhe përcaktimi i statusit me bazë grupi dhe kanalet që shpiten drejt rezidencës afatgjatë, duhet të shoqërohet edhe me skema mbështetjeje financiare nga BE-ja për të zbutur kostot afatgjata të integritit të personave të zhvendosur nga Ukraina në shoqëritë e vendeve pritëse.

2

ZBATIMI DHE PËRDORIMI I KARTËS NË NIVEL KOMBËTAR

Strategjia për Kartën e BE-së për periudhën 2020–2030 dhe përfundimet e Këshillit të vitit 2021 që lidhen me të mbeten dokumentet kryesore që orientojnë veprimet përkatëse në nivel kombëtar dhe në nivel të Bashkimit Evropian. Në nivel kombëtar, procedurat gjyqësore vazhdojnë t'i referohen Kartës dhe, me raste, e njëjta gjë ka ndodhur me procedurat legjislative. Megjithatë, përndryshe, përdorimi i Kartës mbetet i kufizuar.

Në administratat kombëtare, në ato të qarqeve dhe në administratat vendore zor se gjen shembuj të politikave të përqendruara te Karta. Përdorimi i fondeve të BE-së përbën përjashtim. Rregullorja “Për dispozitat e përbashkëta” e bën shumë të qartë detyrimin për të respektuar Kartën. Një tjetër element i spikatur i Kartës në nivel kombëtar lidhet me pikat e sapoemëruara të kontaktit të Kartës në administratat kombëtare.

Institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut në Shtetet Anëtare të përzgjedhura dhanë mendime eksperte për Kartën në procedurat legjislative, administrative ose gjyqësore. Megjithatë, institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut dhe shoqërisë civile ende u mungojnë kapacitetet ose vetëdija për të përdorur Kartën në mënyrë më aktive në punën e tyre. Nevoja për trajnim të vazhdueshëm gjyqësor për Kartën duket se po pranohet gjithmonë e më shumë dhe Komisioni Evropian po e financon.



Karta është e zbatueshme në nivel federal, në nivel qarku dhe në nivel bashkiak. Strategjia e BE-së për Kartën 2020–2030 thekson nxitjen e zbatimit të Kartës në të gjitha nivelet. Megjithatë, përkundrejt këtij sfondi, Shtetet Anëtare duket se nuk kanë angazhim të strukturuar për zbatimin e strategjisë së Kartës, për shembull një përkufizim të qartë të objektivave, gurëve kilometrikë dhe shtrirjes kohore.

Shembujt e mirë të përdorimit të Kartës në nivel kombëtar, qarku dhe vendor janë të kufizuar. Ata më shumë lidhen me monitorimin e përdorimit të fondeve të BE-së. Duket se ka mungesë të veprimeve të integruara në të gjitha nivelet e ekzekutivit, ashtu siç kërkohet nga Përfundimet e Këshillit të vitit 2021 për rritjen e zbatimit të Kartës.

Po këto përfundime vënë në dukje se pikat e kontaktit për Kartën mund të përdoren për të nxitur dhe bashkërenduar ngritjen e kapaciteteve, shkëmbimin e informacionit dhe rritjen e ndërgjegjësimit për Kartën. Në fund të vitit 2022, 24 Shtete Anëtare i kishin emëruar pikat e kontaktit për Kartën. Vetëm Irlanda, Malta dhe Sllovenia ishin ende në proces emërimi. Megjithatë, potenciali i tyre për ndarjen e njohurive dhe rolin e bashkërendimit mbetet për t'u zhvilluar më tej.

Provat tregojnë se situata është më pozitive në fushën e trajnimit, ku për profesionistët e drejtësisë po jepen gjithmonë e më shumë trajnime specifike për Kartën. Megjithatë, trajnime të ngjashme për nëpunësit civilë duket se janë të disponueshme në shumë pak Shtete Anëtare.

Situata është më keq në nivel qarku dhe në nivel vendor. Karta është njësoj e zbatueshme atje, por trajnimet specifike për Kartën duket se mungojnë. Vetëm pak bashki duken se kanë fokus specifik për të drejtat themelore, siç shprehet FRA-ja në raportin *Qytetet e të drejtave të njeriut në BE: Një kuadër për të fuqizuar të drejtat në nivel vendor*.

Rregullorja “Për dispozitat e përbashkëta” përfshin si kushtet mundësuese horizontale (neni 9, paragrafi 1) ashtu edhe kushtet mundësuese tematike (neni 15, paragrafi 1), për shembull ato për aftësinë e kufizuar dhe përfshirjen e romëve. Sipas kësaj rregulloreje (neni 8), Shtetet Anëtare duhet të organizojnë dhe zbatojnë partneritet gjithëpërfshirës për zbatimin e fondeve përkatëse të BE-së, duke u mbështetur në qasjen e qeverisjes në shumë nivele dhe duke siguruar përfshirjen e “organizatave joqeveritare dhe të organeve përgjegjëse për nxitjen e përfshirjes shoqërore, të të drejtave themelore, të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, të barazisë gjinore dhe të mosdiskriminimit”. Shtetet Anëtare duhet të marrin masa për të siguruar që projektimi, zbatimi, monitorimi dhe rivlerësimi fondeve të BE-së të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile dhe me të gjitha palët e interesuara përkatëse, duke përfshirë ato në nivel qarku dhe në nivel vendor.

Në vitin 2022, vetëm pak prej Shteteve Anëtare filluan të merrnin masa për të zbatuar Rregulloren “Për dispozitat e përbashkëta” në pajtim me Kartën. Këto masa nisin që nga miratimi i udhëzimeve që shpjegojnë detyrimet kundrejt Kartës gjatë zbatimit të fondeve të BE-së dhe arrijnë deri te veprimet më konkrete, si ngritja e komiteteve për monitorimin dhe e mekanizmave për ankesat. Roli i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe i shoqërisë civile në këto komitete ndryshon nga një Shtet Anëtar në tjetrin, duke nisur nga një rol aktiv në verifikimet *ex ante* të të gjitha projekteve dhe në përpunimin e ankesave në kuadrin e Kartës, duke kaluar drejt një funksioni këshillimor e duke përfunduar deri te mungesa e plotë e rolit të tyre.

Për të ardhur keq, deri më sot vetëm një Shtet Anëtar ka konsideruar shprehimisht Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në proceset e pajtueshmërisë dhe monitorimit, pavarësisht se konventa është detyruese për të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së dhe për vetë BE-në. Kjo gjë duket se nuk respekton parimin e integritimit të personave me aftësi të kufizuar, parashikuar në nenin 26 të Kartës.



OPINIONI 2.1 I FRA-SË

Shtetet Anëtare duhet të rritin mbështetjen dhe njohuritë për Kartën në të gjitha nivelet e administratës kombëtare, brenda sistemit gjyqësor dhe në forcat e rendit. Këtu mund të përfshiheshin ndarja e njohurive nëpërmjet pikës së kontaktit për Kartën dhe veprimtaritë e trajnimit për juristët që zbatojnë të drejtën e BE-së në nivel kombëtar, në nivel qarku dhe në nivel vendor. Shtetet Anëtare që nuk e kanë emëruar ende pikën e kontaktit për Kartën duhet ta bëjnë këtë dhe të inkurajojnë aktivisht përdorimin e burimeve të disponueshme, të mjeteve dhe materialeve të trajnimit për Kartën me qëllim që të ngrihen kapacitetet dhe të ndahen njohuritë.

Bashkive u bëhet thirrje të bëhen “qytete të të drejtave të njeriut” dhe të integrojnë Kartën në të gjitha veprimtaritë e tyre. Ato ftohen të përdorin kuadrin e FRA-së për të përforcuar të drejtat në nivel vendor, gjë që përfshin mjete për të integruar standardet e të drejtave të njeriut – ku përfshihet edhe Karta – në punën e tyre.

Institucionet e BE-së duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha për të mbështetur Kartën në nivelet kombëtare dhe vendore, nëpërmjet financimeve të shënjestruara për Shtetet Anëtare, për autoritetet në nivel vendor dhe në nivel qarku dhe për përhapësit e dijeve si dhe duke ndarë së bashku praktikatat më të mira për ngritjen e kapaciteteve.



OPINIONI 2.2 I FRA-SË

Për të siguruar respektimin e plotë të Kartës në zbatimin e fondeve të Bashkimit Evropian, Shtetet Anëtare duhet të ngrënë komitete monitorimi që të jenë mjaftueshëm gjithëpërfshirës. Organet publike të ngarkuara me të drejtat themelore, si institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut dhe organizatat e shoqërisë civile, duhet të përfshihen në këto komitete dhe të kenë të paktën rol këshillimor formal. Autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare duhet të raportojnë për marrjen e duhur në konsideratë të opinioneve të tyre.

Për t'u dhënë mundësinë institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut dhe shoqërisë civile që ato të marrin pjesë vërtet në proceset e monitorimit, Shtetet Anëtare duhet t'u japin atyre financime të mjaftueshme dhe trajnime të lidhura me këtë temë.

Në përputhje me Rregulloren “Për dispozitat e përbashkëta”, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që komitetet e tyre të monitorimit, përkrah respektimit të Kartës së të Drejtave Themelore, të konsiderojnë edhe respektimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, sipas parashikimeve të Rregullores “Për dispozitat e përbashkëta”.



OPINIONI 2.3 I FRA-SË

Si pjesë e veprimtarisë së tyre për të rritur zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian dhe sundimin e ligjit, institucionet e BE-së dhe Shtetet Anëtare duhet të forcojnë të gjithë aktorët përkatës në sistemet kombëtare për të drejtat e njeriut. Këtu hyn monitorimi i rregullt i hapësirës civile, duke përfshirë në mënyrë të ngushtë aktorët e shoqërisë civile dhe mbrojtësit e tjerë të të drejtave të njeriut, duke u mbështetur në të dhënat e mbledhura nga FRA-ja.

Shtetet Anëtare duhet të marrin masa për të siguruar hetimin dhe ndëshkimin e duhur të atyre që sulmojnë, ngacmojnë ose kërcënojnë mbrojtësit e të drejtave të njeriut.

Shtetet Anëtare dhe BE-ja duhet të vazhdojnë të financojnë kapacitetet operationale për shoqërinë civile që të përfshijnë trajnime specifike për Kartën. Shtetet Anëtare ftohen të përdorin edhe programin "Qytetarë, Barazi, të Drejta dhe Vlera" për të financuar trajnimet që lidhen me Kartën dhe për të vënë në përdorim mjetet e disponueshme të zhvilluara nga FRA-ja dhe institucione të tjera.

Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që nivelet e ndryshme të qeverisë të komunikojnë dhe bashkëpunojnë me mbrojtësit e të drejtave dhe me organizatat e shoqërisë civile.

Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut dhe aktorët e shoqërisë civile të punojnë në një mjedis mundësues, ku funksionimi i tyre të sigurohet me burimet e mjaftueshme operationale. Aty ku nuk ekzistojnë ende institucione kombëtare për të drejtat e njeriut plotësisht të pavarura, Shtetet Anëtare duhet t'i krijojnë ato.

Parlamenti Evropian dhe Komisioni Evropian kanë pranuar rolin vendimtar të shoqërisë civile në mbështetjen dhe mbrojtjen e të drejtave të mishëruara në Kartë. Për të garantuar që shoqëria civile ta kryejë vërtet këtë detyrë, duhet krijuar një mjedis mundësues.

Provat e FRA-së tregojnë se organizatat e shoqërisë civile në të gjithë BE-në e kanë të vështirë t'u qasen financimeve, të mbrohen nga ngacmimet, kërcënimet dhe sulmet, t'i qasen drejtësisë, të marrin pjesë në vendimmarrjen politike dhe të komunikojnë me autoritetet publike. Në Shtetet Anëtare ka shembuj të shumtë të praktikave premtuese dhe lidhen më së shumti me mundësitë e financimit dhe me përmirësimin e pjesëmarrjes.

Krahas një hapësire civile të lulëzuar, strategjia e Kartës i referohet edhe rolit kyç të institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut. Ajo nënvizon se këto institucione "monitorojnë vënien në jetë, zbatimin dhe përkrahjen e Kartës në terren, u japin informacion viktimitave të shkeljes së të drejtave themelore dhe bashkëpunojnë me institucionet kombëtare për të përmirësuar përdorimin e Kartës nga ana e tyre dhe për ndërgjegjësimin e tyre për Kartën." Në fund të periudhës së raportimit, 19 Shtete Anëtare kishin institucione kombëtare për të drejtat e njeriut me status akreditimi "A", katër prej tyre kishin institucione kombëtare për të drejtat e njeriut me status "B", Rumania kishte një me status "C", dhe vetëm Çekia, Italia dhe Malta nuk kishin një institucion kombëtar për të drejtat e njeriut të akredituar.

3

BARAZIA DHE MOSDISKRIMINIMI

Miratimi i Direktivës “Për trajtimin e barabartë” ka mbetur në vend që nga viti 2008. Kuadri ligjor për krimet nga urrejtja dhe gjuhën e urrejtjes ende nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme për personat LGBTI-lesbikë, gej, biseksualë, transgjinatorë dhe interseks. Në vitin 2022, Komisioni Evropian propozoi legjislacion që synonte të forconte mandatin dhe pavarësinë e organeve të ngarkuara me çështjen e barazisë.

Në BE dhe në nivel kombëtar janë bërë përpjekje për të përkrahur të drejtat e personave LGBTIQ (lesbikë, gej, biseksualë, trans, jobinarë, interseks dhe queer), sidomos sa i takon statusit të familjes dhe prindërimit. Ka pasur disa zhvillime në të gjithë BE-në për të mbuluar shkaqet e tjera për diskriminim, si gjendja shoqërore-ekonomike, gjendja shëndetësore dhe pamja fizike.



Diskriminimi për një sërë shkaqesh ende vazhdon në të gjithë BE-në. Neni 21 i Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore ndalon diskriminimin bazuar në çfarëdo shkak si gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose shoqërore, tiparet gjenetike, gjuha, feja apo besimi fetar, mendimi politik ose ndonjë mendim tjetër, përkatësia në një pakicë kombëtare, pasuria, lindja, aftësia e kufizuar, mosha ose orientimi seksual. Megjithatë, sipas akteve nënligjore të BE-së, disa nga karakteristikat e mbrojtura të parashikuara në nenin 19 të TFBE-së – gjinia dhe origjina racore ose etnike – gëzojnë mbrojtje më të gjerë se të tjerat si feja ose besimi fetar, mosha, aftësia e kufizuar dhe orientimi seksual. Kjo gjë shpie drejt një hierarkie artificiale shkaqesh, gjë që kufizon gjerësinë dhe fushëveprimin e mbrojtjes nga diskriminimi në të gjithë BE-në. Direktiva e propozuar “Për trajtimin e barabartë” do ta mbyllte këtë hendek, por unanimiteti i kërkuar në Këshill për të miratuar propozimin e Komisionit të vitit 2008 ende nuk është arritur.

Ky vit dëshmoi përpjekje të përtëritura për ta thyer pikën e vdekur për këtë instrument vendimtar, në veçanti thirrjet për miratimin e tij të shpejtë nga Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian dhe në rezolutat e Parlamentit Evropian.



OPINIONI 3.1 I FRA-SË

BE-ja dhe Shtetet Anëtare duhet të vazhdojnë të shqyrtojnë të gjitha rrugët e mundshme për të ofruar mbrojtje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme kundër diskriminimit për shkak të fesë ose besimit fetar, aftësisë së kufizuar, moshës ose orientimit seksual në të gjitha fushat kryesore të jetës.

OPINIONI 3.2 I FRA-SË

BE-ja dhe Shtetet Anëtare të BE-së duhet të sigurojnë që organet e ngarkuara me çështjet e barazisë të mund të arrijnë potencialin e tyre të plotë dhe të kontribuojnë me efektshmëri për zbatimin e të gjitha direktivave për barazinë. Kjo do të thotë të garantohet që organeve të ngarkuara me çështjen e barazisë t'u jepen mandate të gjera të mjaftueshme dhe t'u caktohen burimet e duhura njerëzore, financiare dhe teknike për të kryer në mënyrë të efektshme dhe të pavarur detyrat që u janë caktuar me ligj.

BE-ja duhet të sigurojë miratimin e menjëhershëm të dy propozimeve legjislative të Komisionit për të vendosur standarde detyruese për organet e ngarkuara me çështjen e barazisë në BE, në mënyrë që të nxitet trajtimi i barabartë dhe të luftohet diskriminimi për të gjitha shkaqet në fushat e parashikuara nga Direktivat "Për barazinë".

Organet e ngarkuara me çështjet e barazisë nxitin trajtimin e barabartë duke rritur zbatimin e ligjit të BE-së kundër diskriminimit. Provat e FRA-së tregojnë në mënyrë të vazhdueshme se incidentet e diskriminimit rrallë sillen në vëmendjen e autoriteteve kompetente të ngritura për të ndihmuar qasjen e sigurt te drejtësia në shkallë të barabartë për të gjitha viktimat e diskriminimit.

Në detyrat thelbësore të organeve të ngarkuara me çështjet e barazisë hyjnë asistenca për viktimat e diskriminimit në vijimin e ankesave të tyre, monitorimi dhe raportimi për diskriminimin dhe rritja e ndërgjegjësimit për të drejtat e personave. Pavarësisht punës së tyre të qenësishme, organet e ngarkuara me çështjet e barazisë vazhdojnë të përballen me sfida të ndryshme që lidhen me pavarësinë, mandatet dhe pushtetet e tyre, me mungesën e burimeve të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe teknike si dhe me aftësinë e kufizuar për të dhënë kontribut në zhvillimin e politikave. Zbatimi efektiv i legjislacionit ekzistues për barazinë kërkon struktura të forta dhe të pavarura, mekanizma për të rritur respektimin e ligjit si dhe rritjen e besimit të publikut te organet që merren me garantimin dhe mbështetjen e vlerës së barazisë.

Në këtë aspekt, roli i organeve efektive të ngarkuara me çështjet e barazisë është vendimtar. Kjo gjë është theksuar në propozimet legjislative të Komisionit për të forcuar organet që merren me barazinë, legjislacion që synon të sigurojë pavarësinë, burimet dhe pushtetin e tyre, në mënyrë që ato të mund të mbrojnë viktimat dhe të parandalojnë diskriminimin në mënyrë më të efektshme.

OPINIONI 3.3 I FRA-SË

Shtetet Anëtare të BE-së inkurajohen të vazhdojnë të miratojnë dhe zbatojnë masa specifike (duke përfshirë plane kombëtare veprimi të barazisë për LGBTIQ+) për të garantuar që personat lesbike, gej, biseksualë, trans, jobinarë, interseks dhe queer të mund të gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre themelore. Gjatë kësaj pune, Shtetet Anëtare duhet t'u japin konsideratën e duhur *Udhëzimeve për Strategjitë dhe Planet e Veprimit për të Rritur Barazinë e LGBTIQ*, të përgatitura nga Nëngrupi për Barazinë e LGBTIQ dhe të miratuara nga Grupi i Nivelit të Lartë për mosdiskriminimin, barazinë dhe larminë.

Shtetet Anëtare të BE-së inkurajohen të mbledhin dhe përdorin rregullisht të dhënat SOGIESC për barazinë në mënyrë që të zhvillojnë politika dhe përgjigje ligjore të mbështetura në prova.

Shtetet Anëtare duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të luftuar me efektshmëri gjuhën e urrejtjes dhe të trajtojnë ndikimin e dëmshëm të deklarimeve homofobike dhe transfobike të bëra në debatet publike, në fushatat politike, në medie dhe në internet.

Në vitin 2022, një numër Shtetesh Anëtare morën hapa për të mbështetur të drejtat themelore të personave të komunitetit LGBTIQ+ (lesbike, gej, biseksualë, transgjitorë, interseks dhe queer+) duke bërë ndryshime ligjore dhe duke marrë masa politike në fusha të tilla si statusi i familjeve të së njëjtës gjini, birësimi dhe prindërimi; procedurat e thjeshtuara për njohjen e gjinisë në bazë të vetëpërcaktimit dhe parandalimi dhe ndëshkimi i gjuhës së urrejtjes dhe krimeve nga urrejtja. Në mjaft Shtete Anëtare, ku kuadri legjislativ ishte i papërshtatshëm, gjykatat shtruan rrugën për zhvillime legjislative ose siguruan zbatimin e duhur të tij.

Disa Shtete Anëtare kanë bërë ndryshime ligjore dhe kanë marrë masa politike që rrezikojnë të drejtat themelore për trajtim të barabartë të personave LGBTIQ+. Kjo ka ndikim të prekshëm në rritjen e armiqësisë dhe dhunës kundër komunitetit LGBTIQ dhe të frikës ndër ta, te familjet e tyre dhe te qytetarët e tjerë të cilët i tremben shtypjes për shkak se mbështetin barazinë. Gjuha e urrejtjes është një dukuri veçanërisht shqetësuese, pasi nxit edhe më shumë diskriminimin. Në të njëjtën kohë, mbledhja e rregullt e të dhënave të barazisë (SOGIESC) për orientimin seksual, identitetin gjinor, shprehjen gjinore dhe karakteristikat e seksit mbetet e rrallë në shumicën e Shteteve Anëtare.

“Diskriminimi i kryqëzuar” përshkruan një situatë në të cilën disa shkaqe hyjnë dhe ndërveprojnë me njëri-tjetrin në atë mënyrë që bëhen të pandashme dhe prodhojnë lloje të posaçme diskriminimi. Profesionistët e kësaj fushe pranojnë se trajtimi i diskriminimit nga perspektiva e një shkakut të vetëm nuk arrin të kapë larminë e mënyrave me të cilat njerëzit përjetojnë diskriminimin në jetët e tyre të përditshme. Megjithatë, ligjet e BE-së ende nuk i mbrojnë plotësisht njerëzit nga diskriminimi i kryqëzuar.

Equinet ka treguar nevojën për të zgjeruar listën e shkaqeve të diskriminimit për të përfshirë aty origjinën shoqërore dhe/ose gjendjen shoqërore-ekonomike, statusin familjar, trashëgiminë gjenetike, gjendjen shëndetësore, pamjen fizike etj.



OPINIONI 3.4 I FRA-SË

BE-ja dhe Shtetet Anëtare duhet të konsiderojnë përfshirjen e diskriminimit të kryqëzuar në legjislacionin e zbatueshëm.



4

RACIZMI, KSENOFOBIA DHE INTOLERANCA E LIDHUR ME TO

Diskriminimi i bazuar te origjina racore ose etnike, krimet e motivuara nga paragjykimi dhe gjuha raciste mbetën gjerësisht të përhapura në vitin 2022. Provat tregojnë të dhëna për racizëm sistemik, madje edhe brenda forcave të rendit. Sulmi i Rusisë kundër Ukrainës çoi drejt shfaqjes së rasteve të gjuhës së urrejtjes dhe sulmeve të dhunshme në disa Shtete Anëtare të BE-së.

Komisioni Evropian vazhdoi procedurat e shkeljes kundër 12 Shteteve Anëtare sepse nuk kishin trupëzuar plotësisht ose saktësisht Vendimin Kuadër "Për racizmin dhe ksenofobinë" në legjislacionin e brendshëm. Në të njëjtën kohë, disa Shtete Anëtare ndryshuan legjislacionin e tyre për të kriminalizuar krimet nga urrejtja dhe gjuhën e urrejtjes. Parlamenti Evropian gjithashtu i ka shtyrë Shtetet Anëtare të garantojnë zbatimin e plotë dhe monitorimin e efektshëm të Direktivës "Për barazinë racore".

Komisioni Evropian u bëri thirrje Shteteve Anëtare që deri në fund të vitit 2022 të miratonin planet kombëtare të veprimit kundër racizmit, siç e parashikon Plani i Veprimit të BE-së kundër racizmit dhe Strategjia e BE-së për të Luftuar Antisemitizmin dhe për të Përkrahur Jetën Hebreje. Vetëm gjysma e tyre i kanë miratuar këto plane. Disa Shtete Anëtare kanë bërë përpjekje të shënjestruara për të lehtësuar kallëzimin e incidenteve raciste; ata kanë forcuar qasjen e viktimave të mbështetja, mbrojtja dhe të drejtësia.



Vendimi Kuadër “Për racizmin dhe ksenofobinë” (2008/913/DPB) parashtron një qasje të përbashkët të legjislacionit penal për format e racizmit dhe ksenofobisë që arrin deri në gjuhë urrejtjeje dhe krim nga urrejtja. Komisioni Evropian vazhdoi procedurën e shkeljes kundër 12 Shteteve Anëtare që nuk e kishin trupëzuar plotësisht dhe me saktësi vendimin kuadër në legjislacionin e brendshëm. Në të njëjtën kohë, disa Shtete Anëtare ndryshuan kodet e tyre penale për të kriminalizuar krimet nga urrejtja dhe gjuhën e urrejtjes dhe morën masa për të lehtësuar kallëzimin e incidenteve raciste.

Racizmi vazhdoi të përbente një sfidë serioze në BE gjatë vitit 2022. Siç e tregojnë të dhënat zyrtare dhe jozyrtare, krimet e nxitura nga urrejtja raciste dhe incidentet nga gjuha e urrejtjes vazhduan të ndodhnin. Përveç kësaj, organizmat ndërkombëtare dhe kombëtare të të drejtave të njeriut ngritën shqetësime për nivelin në rritje të gjuhës së urrejtjes në internet dhe shpesh nga mediet dhe politikanët, gjuhë që vinte në shënjestër hebrenjtë, myslimanët, migrantët dhe pakicat etnike.

Neni 21 i Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore e ndalon diskriminimin për shkak të origjinës etnike ose racës. Po ashtu, Direktiva “Për barazinë racore” (2000/43/KE) ndalon diskriminim për shkak të origjinës etnike ose racore në qasjen në arsim, punësim, shërbime, duke përfshirë strehimin dhe kujdesin shëndetësor. Siç e tregojnë raportet e organeve kombëtare për monitorimin e të drejtave të njeriut, një numër Shtetesh Anëtare ende nuk i zbatojnë plotësisht dispozitat e direktivës.

Komisioni i vazhdoi procedurat e shkeljes kundër tri Shteteve Anëtare që diskriminuan fëmijët e komunitetit rom në arsim. Rezultatet e anketës dhe të testimeve për diskriminimin nxjerrin në dritë se në vitin 2022 pakicat etnike, duke përfshirë migrantët, vazhduan të pësonin diskriminim dhe racizëm në fusha të ndryshme të jetës.

Nën dritën e provave të vazhdueshme për racizëm sistemik, organet evropiane dhe ndërkombëtare bënë thirrje për përpjekje të shënjestruara për të trajtuar racizmin e evidentuar në disavantazhet më të gjera politike dhe shoqërore për personat me origjinë racore dhe nga pakicat etnike.



OPINIONI 4.1 I FRA-SË

Shtetet Anëtare të BE-së duhet të transpozojnë plotësisht e me saktësi dhe të zbatojnë dispozitat e Vendimit Kuadër të Këshillit “Për luftën ndaj racizmit dhe ksenofobisë”. Këtu përfshihet edhe marrja e masave nga Shtetet Anëtare për të garantuar që motivet raciste ose ksenofobe të konsiderohen rrethana rënduese ose, si alternativë, që gjykatat t’i marrin këto motive në konsideratë në përcaktimin e dënimeve.



OPINIONI 4.2 I FRA-SË

Shtetet Anëtare të BE-së duhet të përmirësojnë ndjeshëm efektshmërinë e masave dhe të dispozitave të tyre institucionale për të zbatuar plotësisht dispozitat e Direktivës “Për barazinë racore”, sidomos në lidhje me sanksionet e efektshme, të përpjesëtuara dhe frenuese në rast shkeljeje të detyrimeve, siç e kërkon Direktiva “Për barazinë racore”. Shtetet Anëtare inkurajohen të intensifikojnë përpjekjet për të luftuar racizmin në të gjitha sphaqjet e tij, duke përfshirë racizmin sistemik.

OPINIONI 4.3 I FRA-SË

Shtetet Anëtare të BE-së inkurajohen të zhvillojnë sa më shpejt plane kombëtare veprimi ose strategji enkas për të luftuar racizmin, diskriminimin racor, antisemitizmin, ksenofobinë dhe intolerancën që lidhet me to. Për të mbështetur dhe pasqyruar përpjekjet kombëtare në terren, politikat kombëtare duhet të përkthehen në masa dhe veprime konkrete në nivel qarqesh dhe në nivel vendor. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që, kur zhvillojnë, zbatojnë dhe monitorojnë planet e veprimit kundër racizmit, të gjitha veprimet të udhëhiqen nga një qasje pjesëmarrëse dhe të jenë të bazuara në të dhëna të besueshme për barazinë.

OPINIONI 4.4 I FRA-SË

Shtetet Anëtare të BE-së inkurajohen të rritin trajnimet për oficerët e forcave të rendit. Ato duhet të rritin edhe vlerësimin e garancive ekzistuese kundër racizmit, edhe duke krijuar sisteme të fuqishme për rishikimin e performancës. Shtetet Anëtare duhet të garantojnë që rastet e dhunës së policisë kundër migrantëve dhe pakicave etnike të hetohen me shpejtësi dhe në mënyrë të pavarur dhe që viktimat të ndihmohen për të kallëzuar sjelljen e keqe të policisë.

Autoritetet e forcave të rendit duhet të nxjerrin udhëzues specifikë, praktikë dhe të gatshëm për përdorim kundër profilizimit etnik diskriminues nga oficerët e forcave të rendit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre. Këta udhëzues duhet të përfshihen në procedurat standarde të punës dhe në kodin e sjelljes dhe duhet t'u komunikohen sistematikisht oficerëve të vijës së parë.

Në Konferencën Botërore të OKB-së kundër racizmit, Shtetet Anëtare morën angazhime për rritjen e përpjekjeve për të luftuar racizmin. Njëzet e një vite më pas, gjendja e zbatimit në BE nuk është në lartësinë e duhur.

Thirrja për të miratuar planet kombëtare të veprimit kundër racizmit deri në fund të vitit 2022, siç e parashikon Plani i Veprimit të BE-së kundër racizmit dhe Strategjia e BE-së për të Luftuar Antisemitizmin dhe për të Përkrahur Jetën Hebreje u përmbush deri në gjysmë. Deri në fund të vitit 2022, rreth gjysma e Shteteve Anëtare kishin plane të posaçme veprimi kundër racizmit dhe kishin marrë masa të integruara, ndërsa 15 të tjerë kishin një strategji antisemitizëm më vete ose e kishin përfshirë luftën ndaj antisemitizmit nën strategji më të gjera. Në disa vende, ka pasur përpjekje të shënjestruara në nivel vendor dhe në nivel qarku, duke pasqyruar kështu një kuptim më të rritur se racizmi duhet të luftohet në të gjitha nivelet dhe me një qasje të bashkërenduar dhe pjesëmarrëse.

Organet evropiane dhe ndërkombëtare kanë bërë thirrje për veprim për të trajtuar racizmin në sjelljen dhe në profilizimin diskriminues nga forcat e rendit. Këto qëndrime bien ndesh me parimet e Konventës Ndërkombëtare "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor" dhe me standardet e tjera ndërkombëtare, duke përfshirë edhe ato të mishëruara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që lidhet me to, si dhe me parimet e Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore. Rekomandimet e Komisionit Evropian kundër racizmit dhe intolerancës theksojnë gjithashtu detyrimin pozitiv që ka policia për të luftuar racizmin dhe diskriminimin racor.

Në vitin 2022, rastet ku ka pasur dhunë policore mund të kenë pasur përfshirje të diskriminimit racor dhe ksenofobik. Gjatë këtij viti u panë dëshmi edhe të profilizimit etnik të paligjshëm. Incidentet raciste dhe profilizimi etnik i paligjshëm dëmtojnë besimin te autoritetet dhe mund të shpien drejt moskallëzimit të krimeve dhe drejt rezistencës ndaj autoritetit publik. Shtetet Anëtare vazhduan të investojnë në trajnime për oficerët e forcave të rendit për të drejtat e njeriut dhe kundër racizmit.



5

BARAZIA DHE PËRFSHIRJA E ROMËVE



Deri në vitin 2022, shumica e Shteteve Anëtare të BE-së kishin zhvilluar plane kombëtare veprimi dhe kishin filluar zbatimin e kornizave kombëtare strategjike për të përmbushur objektivat e vitit 2030 të kuadrit strategjik të BE-së për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve. Gjatë këtij viti, pjesa më e madhe e Shteteve Anëtare hartuan edhe planet kombëtare të veprimit për zbatimin e efektshëm të garancisë për fëmijën, në të cilat Shtetet Anëtare përqendrohen në fuqizimin e arsimimit dhe përfshirjes së fëmijëve romë.

FRA-ja paraqiti rezultatet e anketës për romët të kryer në vitin 2021. Gjetjet e saj tregojnë progres të paktë ose aspak progres që nga anketa e fundit në vitin 2016 për luftën ndaj anticiganizmit dhe për qasjen e barabartë në arsim, punësim, strehim dhe shëndetësi.

Në vitin 2022, të drejtat themelore të romëve dhe endacakëve ende nuk respektoheshin plotësisht. Anticiganizmi, diskriminimi, varfëria dhe përjashtimi social si dhe krimet nga urrejtja dhe gjuha e urrejtjes vazhdojnë të prekin një numër shumë të madh romësh dhe endacakësh në të gjithë BE-në. Incidentet me vdekje nga dhuna e policisë me viktima romë në vitin 2022 tregojnë se duhet të trajtohet racizmi institucional në forcat e rendit.

OPINIONI 5.1 I FRA-SË

Shtetet Anëtare duhet të marrin masa urgjente për t'u ofruar të gjithë romëve, të cilët jetojnë në ngulime të veçuara në kushte të rënda privimi të strehimit, një qasje të denjë në strehim që të jetë i arritshëm, i përballueshëm, i sigurt nga ana mjedisore, i shëndetshëm dhe jo i veçuar.

Për t'i arritur këto objektiva, ata duhet të vënë në përdorim fondet e disponueshme nga BE-ja, sipas parashikimeve të nenit 3 të Rregullores (BE) 2021/1058 për Fondin Evropian të Zhvillimit të Rajoneve dhe për Fondin e Kohesionit, objektivi specifik (iii) mbështetja e përfshirjes socio-ekonomike e komuniteteve të marginalizuara, e familjeve me të ardhura të ulëta dhe e grupeve të pafavorizuara, ku përfshihen personat me nevoja të veçanta, duke ndërmarrë veprime të integruara, përfshirë këtu shërbimet sociale dhe ato të strehimit.

Të dhënat e anketës së FRA-së për romët, e botuar në vitin 2022, tregojnë se një pjesë e madhe e romëve jetojnë në banesa të papranueshme, të veçuar dhe u mungojnë kushtet bazë, atyre shpesh u mungon edhe qasja në ujë dhe pastër të çezmës.

Në tetor 2022, rezoluta e Parlamentit Evropian për situatën e romëve që jetojnë në ngulime nëpër Evropë i kërkonte Komisionit Evropian dhe Shteteve Anëtare të zgjidhin me urgjencë situatën e romëve që jetojnë në ngulime në mënyrë përfshirëse dhe të efektshme, me politika të përshtatshme afatshkurtra dhe afatgjata të mbështetura me financime të mjaftueshme nga BE-ja dhe nga buxhetet kombëtare. Në këtë rezolutë Parlamenti Evropian thekson edhe se këto kushte katastrofike si dhe ndikimi negativ psikologjik dhe sociologjik i veçimit, jo vetëm prek njerëzit të jetojnë në këto ngulime, por kanë ndikim edhe në komunitetin më të gjerë.

OPINIONI 5.2 I FRA-SË

Shtetet Anëtare inkurajohen të krijojnë platforma dhe të ndërtojnë kapacitetet e shoqërisë civile të romëve duke përfshirë gratë, fëmijët dhe të rinjtë. Shtetet Anëtare duhet të konsiderojnë praktikën premtuese në vende të tjera të BE-së dhe të vënë në përdorim të plotë fondet e disponueshme të BE-së për të ngritur platforma bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile dhe me palët e interesuara në nivel vendor dhe në nivel qarku për zbatimin, monitorimin dhe rishikimin e planeve kombëtare të veprimit dhe të strategjive kombëtare.

Rekomandimi i Këshillit të BE-së i vitit 2021 për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve (2021/K 93/01) thekson nevojën që Shtetet Anëtare të përshpejtojnë pjesëmarrjen kuptimplotë të personave romë dhe konsultimin e tyre. Monitori Civil për Romët i vitit 2022 pranon se intensiteti dhe cilësia e pjesëmarrjes së romëve dhe e OJF-ve në përgatitjen e kornizave kombëtare strategjike për romët dhe në përgatitjen e planeve kombëtare të veprimit është përmirësuar krahasuar me të shkuarën. Megjithatë, angazhimi aktiv i pjesëmarrjes së shoqërisë civile mungon plotësisht në mjaft Shtete Anëtare dhe vetëm pak Shtete Anëtare kanë nisur platforma të qëndrueshme dhe gjerësisht përfaqësuese të romëve dhe ndërtimin e kapaciteteve të shoqërisë civile të romëve për të garantuar pjesëmarrjen e plotë në të gjitha nivelet.

Rekomandimi i Këshillit të BE-së i vitit 2021 për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve (2021/K 93/01) i kërkon Shteteve Anëtare të BE-së të monitorojnë dhe vlerësojnë zbatimin e kornizave kombëtare strategjike. Plani i BE-së kundër racizmit u kërkon Shteteve Anëtare, në respekt të plotë të konteksteve të tyre kombëtare, të shkojnë drejt mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave për barazinë, të bazuara në origjinën racore ose etnike, në mënyrë që të kapen si përvojat subjektive të diskriminimit dhe viktimizimit ashtu edhe aspektet e racizmit dhe diskriminimit në nivel sistemi.

Ende, të dhënat e disponueshme për barazinë janë të copëzuara dhe jo të harmonizuara ndërmjet vendeve, burimeve të të dhënave dhe mbledhësve të të dhënave. Kjo gjë mund të shihet edhe në mungesën e të dhënave për romët që i kanë ikur luftës së agresionit të Rusisë kundër Ukrainës. Në vitin 2022, disa Shtete Anëtare përshpejtuan zhvillimin e mbledhjes së të dhënave të reja ose përmirësimin e të dhënave të mbledhura nëpërmjet regjistrimit kombëtar të popullsisë për të përfshirë në to karakteristikat e barazisë.

Disa Shtete Anëtare ua ngarkuan organeve të reja ose ekzistuese për të drejtat e njeriut mbledhjen e të dhënave dhe dokumentimin e incidenteve kundër ciganëve. Megjithatë, jo të gjitha përpjekjet për mbledhjen e të dhënave ishin në përputhje me parimet e Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të OKB-së lidhur me të drejtat e njeriut në mbledhjen e të dhënave dhe me rekomandimet e Grupit të Nivelit të Lartë të BE-së për mosdiskriminimin, barazinë dhe lirinë të përshkuara në shënimin udhëzues të BE-së për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave për barazinë të bazuara në origjinën racore ose etnike.



Neni 14 i Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore (Karta) shenjtëron të drejtën për arsim. Një nga katër objektivat sektoriale të kuadrit strategjik të BE-së për romët është që fëmijët e të gjitha prejardhjeve racore ose etnike duhet të kenë qasje të barabartë në arsim. Kjo është gjithashtu në pajtim me Direktivën "Për barazinë racore".

Në Strategjinë Evropiane për Kujdesin, Komisioni u ka kërkuar Shteteve Anëtare t'u ofrojnë fëmijëve romë mundësi të barabarta. Të njëjtën gjë bëri Këshilli në rekomandimin e tij që themelon Garancinë Evropiane për Fëmijën.

Të dhënat e Anketës së FRA-së për Romët në vitin 2021 tregojnë se hendeku arsimor midis fëmijëve romë dhe fëmijëve nga popullsia e përgjithshme mbetet i madh, me normë të lartë braktisjeje të shkollës pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm. Madje veçimi në arsim është rritur që nga viti 2016.



OPINIONI 5.3 I FRA-SË

Shtetet Anëtare të BE-së duhet të vazhdojnë të bëjnë të gjitha përpjekjet për të garantuar monitorimin e efektshëm nëpërmjet mbledhjes dhe përdorimit të rregullt të të dhënave për barazinë. Këto përpjekje duhet të monitorojnë përdorimin e fondeve si dhe masat dhe programet për të përmbushur objektivat e vitit 2030 për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve.

Shtetet Anëtare inkurajohen të sigurojnë që mbledhja e të dhënave prej tyre, duke përfshirë regjistrimin kombëtar të popullsisë, të jetë në përputhje me qasjen ndaj të dhënave të bazuar te të drejtat e njeriut. Ata duhet të marrin në konsideratën e duhur orientimet e BE-së për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave për barazinë, të bazuara te origjina racore ose etnike.

Shtetet Anëtare duhet të inkurajojnë dhe të forcojnë aktivisht bashkëpunimin midis shoqërisë civile, botës akademike, organeve të ngarkuara me çështjen e barazisë dhe zyrave të statistikave për të lehtësuar raportimin dhe monitorimin e rregullt të diskriminimit, anticiganizmit dhe të krimeve nga urrejtja.



OPINIONI 5.4 I FRA-SË

Shtetet Anëtare të BE-së duhet t'i japin fund veçimit të romëve në arsim dhe të mbledhin prova të këtij veçimi për të zbatuar plotësisht Direktivën "Për barazinë racore".

Shtetet Anëtare duhet t'u japin përparësi dhe të vënë në përdorim financimet kombëtare dhe ato të BE-së për të ofruar arsim cilësor dhe më shumë mundësi trajnimi për fëmijët romë, duke angazhuar shoqërinë civile romë në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e masave të tyre kombëtare.

OPINIONI 5.5 I FRA-SË

Shtetet Anëtare të BE-së duhet të rritin përpjekjet e tyre për të trajtuar varfërinë dhe përjashtimin shoqëror të romëve. Kjo gjë do të kërkojë masa të shënjestruara ku të kombinohet punësimi i paguar dhe dhënia e pagesave sociale me qëllimin për të arritur objektivin e vitit 2030, i cili është mbyllja e hendekut të varfërisë ndërmjet romëve dhe popullsisë së përgjithshme, siç e kërkon kuadri strategjik i BE-së për romët.

Shtetet Anëtare duhet të trajtojnë në mënyrë specifike fëmijët romë në planet e tyre kombëtare të veprimit deri në vitin 2030 në kuadër të Garancisë Evropiane të BE-së për Fëmijën. Në kryerjen e kësaj pune, ata duhet të marrin parasysh gjetjet dhe rekomandimet e studimeve specifike për vendet, të zhvilluara nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët dhe nga Komisioni Evropian.

Shtetet Anëtare, në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetet e romëve, duhet të identifikojnë, planifikojnë dhe zbatojnë masa efektive për të tërhequr gratë romë në tregun e punës në mënyrë që të rritet pavarësia e tyre ekonomike dhe të mbrohen nga varfëria.

Ulja e varfërisë dhe e përjashtimit nga shoqëria dhe mbyllja e hendekut socio-ekonomik përbën një prej objektivave horizontalë të kuadrit strategjik të BE-së për romët. Garancia Evropiane për Fëmijën është nisma madhore e BE-së për të garantuar që çdo fëmijë në rrezik varfërie ose përjashtimi shoqëror në Evropë të ketë qasje në të drejtat më elementare, si kujdesi shëndetësor dhe arsimi. Kjo nismë identifikon fëmijët romë si veçanërisht të paprivilegjuar dhe u kërkon Shteteve Anëtare të trajtojnë nevojat e tyre.

Rezoluta e Parlamentit Evropian e korrikut 2022 kërkon t'i jepet fund varfërisë së grave dhe emërton gratë romë si grup veçanërisht të cenusëshëm. Objektivi kryesor i BE-së në planin e veprimit të Shtyllës Evropiane për të Drejtat Shoqërore është të ulet me të paktën 15 milionë numri i personave në rrezik varfërie ose përjashtimi shoqëror. Kjo gjë duhet të garantohet për të gjithë me paga me të cilat të sigurojnë jetesën dhe me përfitimin e të ardhurave minimale të përshtatshme për ata që nuk kanë burime të mjaftueshme.

Të dhënat më të fundit të FRA-së të marra nga 10 Shtete Anëtare tregojnë se në vitin 2021, katër ndër pesë romë (80 %), ku përfshihen fëmijët e tyre, ende jetonin në familje në rrezik varfërie dhe në privim të rëndë material (48%). Monitori Civil për Romët 2022 del në përfundimin se strategjitë kombëtare dhe planet e veprimit për romët nuk trajtojnë varfërinë dhe mbrojtjen sociale.



6

AZILI, VIZAT, MIGRACIONI, KUFIJTË DHE INTEGRIMI

Fillimi i luftës së agresionit të Rusisë kundër Ukrainës pati si rezultat regjistrimin e thujtë 4 milionë personave të zhvendosur në BE, siç përshkruhet në kreun në fokus të këtij raporti. Në të njëjtën kohë, rritja globale e lëvizshmërisë pas pandemisë së COVID-19 çoi drejt rritjes së kalimeve të parregullta të kufijve për në BE.

Përgjatë kufijve të jashtëm të BE-së janë raportuar shkelje të rënda dhe të vazhdueshme të të drejtave. Kombinuar me mungesën e hetimeve të menjëhershme dhe efektive, ato përbëjnë sfida serioze për sundimin e ligjit. Shkeljet e të drejtave themelore në kufij u përkeqësuan dhe pandëshkueshmëria për veprimet e paligjshme vazhdon sepse shkeljet nuk janë trajtuar.

Trysnia mbi organizatat e shoqërisë civile nga autoritetet shtetërore dhe nga aktorë të tjerë që mbrojnë të drejtat e migrantëve dhe refugjatëve në kufij është në rritje. Rregullat e BE-së për të reformuar politikën e azilit mbeten pezull me procedurën e legjislatorit të përbashkët në BE. Mekanizmi i mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave të Shengenit po rishikohet, duke i dhënë më shumë vëmendje të drejtave themelore. Instrumentet ligjore që parashikojnë ngritjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë përmbajnë disa garanci për të drejtat themelore; tani sfida kryesore është zbatimi i tyre në praktikë.



Për refugjatët, përveç atyre që i kanë ikur pushtimit rus në Ukrainë, rrugët ligjore për të arritur në mënyrë të sigurt në BE mbeten të kufizuara. Në kontekstin e rritjes së zhvendosjeve të detyruara në shkallë botërore, disa prej tyre mundohen të arrijnë në mënyrë të sigurt duke ardhur në mënyrë të parregullt. Kur kalojnë ose përpiqen ta kalojnë në mënyrë të paligjshme kufirin e jashtëm të BE-së, ata përjetojnë shkelje të të drejtave në disa Shtete Anëtare të BE-së.

Këto shkelje të të drejtave themelore janë serioze, të përsëritura dhe të përhapura gjerësisht. Mjaft kallëzime kanë të bëjnë me sjelljen e zyrtarëve, e cila në ligjin e brendshëm përbën krim të rëndë. Megjithatë, sistemet kombëtare të drejtësisë marrin në ngarkim vetëm pak raste. Kjo gjë mund të çojë drejt ndjesisë së pandëshkueshmërisë.

Shoqëria civile është përbërës kyç i arkitekturës së të drejtave themelore në Evropë dhe luan rol vendimtar në respektimin e të drejtave të njerëzve. Konflikti midis organizatave të shoqërisë civile që mbrojnë të drejtat e migrantëve dhe refugjatëve, nga njëra anë, dhe autoriteteve shtetërore dhe aktorëve joshkëtorë, nga ana tjetër, është duke u rritur.



OPINIONI 6.1 I FRA-SË

Këshilli i Shengenit dhe raportet vjetore të komisionit për "Situatën e Shengenit" duhet t'i kushtojnë një zë të rendit të ditës ose një titull situatës së të drejtave themelore në kufij.

Shtetet Anëtare të BE-së duhet të krijojnë ose forcojnë mekanizmat kombëtarë për të monitoruar të drejtat themelore në kufijtë e tyre, duke u mbështetur në ekspertizën e FRA-së.

OPINIONI 6.2 I FRA-SË

Komisioni Evropian duhet të vazhdojë përpjekjet për të integruar pajtueshmërinë me të drejtat themelore gjatë vlerësimeve të Shengenit. Kur shqyrton programet kombëtare të Shteteve Anëtare të BE-së, Komisioni Evropian duhet të zbatojë të gjitha garancitë për të drejtat themelore të trupëzuara në instrumentet ligjore të BE-së, të cilat kanë themeluar Fondin për Azilin, Migracionin dhe Integrimin si dhe Instrumentin për Menaxhimin e Kufirit dhe Vizat në kuadrin e Fondit të Menaxhimit të Integruar të Kufirit.

Aktet nënligjore të BE-së në fushën e azilit, kufijve dhe migracionit përmbajnë garanci të rëndësishme për të drejtat themelore. Në vitin 2022, pati një vëmendje të rritur për t'i bërë operacionale këto garanci. Rishikimi i mekanizmave të vlerësimit dhe monitorimit të Shengenit e pasqyron këtë gjë. Po e njëjta gjë po bëhet me procedurat për të marrë fonde nga BE-ja. Profesionistët nuk i njohin, integrojnë dhe veprojnë mjaftueshëm me këto garanci.

OPINIONI 6.3 I FRA-SË

BE-ja duhet të marrë në konsideratë ngritjen e një mekanizmi për shqyrtimin e pavarur të sistemeve të TI-së në shkallë të gjerë. Ky mekanizëm do të garantonte shqyrtimin e vazhdueshëm, të pavarur dhe ekspert të ndikimit të sistemeve të TI-së në shkallë të gjerë në BE në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë të të drejtat themelore dhe të dinjiteti i njerëzve. Përvoja e Shqyrtuesit të Pavarur të Legjislacionit për Terrorizmin në Mbretërinë e Bashkuar mund të shërbejë si frymëzim për një mekanizëm të fortë dhe të qëndrueshëm, i cili të jetë i pavarur nga Komisioni Evropian dhe nga agjencitë e BE-së që merren me menaxhimin ose mbështetjen e funksionimit të këtyre sistemeve të TI-së.

Puna për sisteme të teknologjisë së informacionit (TI) në shkallë të gjerë në BE vazhdoi për të lehtësuar menaxhimin e kufijve, për të mbështetur procedurat e azilit dhe për të ulur rreziqet në sigurinë e brendshme. Të dhënat personale, ku përfshihen të dhënat biometrike, të pothuajse të gjithë shtetasve të vendeve të treta që qëndrojnë ose udhëtojnë drejt BE-së do të përpunohen nëpërmjet gjashtë sistemeve të teknologjisë së informacionit të BE-së në shkallë të gjerë.

Garancitë e shumta të trupëzuara në legjislacionin e BE-së synojnë të ulin rrezikun e shkeljeve të të drejtave themelore, nëse zbatohen në mënyrën e duhur. Megjithatë, sistemet TI të BE-së tani po vihen në funksion dhe ende po zbulojmë si punojnë bashkë aspekte të ndryshme të tyre. Prandaj, ndikimi potencialisht i gjerë i tyre në të drejtat themelore mbetet pjesërisht i panjohur.



7

SHOQËRIA E INFORMACIONIT, PRIVATËSIA DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE

Duke nisur nga përdorimi i inteligjencës artificiale (IA) e duke vazhduar me moderimin e përmbajtjes në internet, me ruajtjen e të dhënave, me teknologjitë për njohjen e fytyrës e duke përfunduar me qasjen dhe përdorimin e provave elektronike në hetimet penale, viti 2022 vazhdoi të shtronte një pyetje të përsëritur. Si mund të përdorim në mënyrën më të mirë të gjitha të dhënat e disponueshme në potencialin e tyre të plotë duke respektuar njëkohësisht mbrojtjen e të dhënave dhe garancitë e tjera për të drejtat themelore?

Diskutimet për garancitë e përshtatshme në përdorimet e shumta të IA-së u intensifikuan në të gjithë BE-në. Një vëmendje në rritje iu kushtua të drejtave themelore.

Institucionet ndërkombëtare dhe qeveritë e vendeve, së bashku, debatuan për masën në të cilën policia dhe autoritetet gjyqësore mund t'u qasen të dhënave personale. U intensifikuan nismat që lejojnë përdorimin e teknologjive moderne për mbikëqyrjen dhe qasjen në të dhënat për qëllime sigurie. Paralelisht, u intensifikuan edhe shqetësimet përkatëse të gjykatave, organizatave të shoqërisë civile dhe të autoriteteve publike.



Bisedimet rreth Aktit “Për Inteligjencën Artificiale” (AIA) ecën në mënyrë të qëndrueshme në vitin 2022. Në Parlamentin Evropian u parashtrua një numër i lartë sugjerimesh për ndryshime dhe Këshilli miratoi qëndrimin e përbashkët të tij në dhjetor. Të dy bashkë-ligjvënësist kanë treguar prirje për të futur garanci më të forta për të drejtat themelore në tekstet e propozuara. Megjithatë, garancitë për të drejtat themelore mund të forcohen më tej, për shembull në procedurën e vlerësimit të pajtueshmërisë (në propozimin për nenin 43 dhe Shtojcën VII).

Diskutimet për përkufizimin e IA-së janë në vazhdim, me disa tendenca për të kufizuar në mënyrë thelbësore fushëveprimin e saj. Kjo gjë mund lërë jashtë kuadrit ligjor të propozuar një sërë zbatimesh dhe përdorimesh të IA-së të cilat mund të kenë ndikim negativ në të drejtat themelore.

Paralelisht me këto përpjekje legjislativë në nivel BE-je, disa Shtete Anëtare kanë marrë hapa specifike në vitin 2022 për të siguruar përdorim të sigurt dhe në respekt të të drejtave themelore të IA-së në nivel kombëtar, për shembull duke caktuar një mbikëqyrës të posaçëm për IA-në ose vlerësim të ndikimit të IA-së në të drejtat themelore.



OPINIONI 7.1 I FRA-SË

Bashkë-ligjvënësist në BE duhet të sigurojnë referimin e duhur të garancitë e të drejtave themelore në projekt-Aktin “Për Inteligjencën Artificiale”. Përkufizimi i përgjithshëm i IA-së nuk duhet të ngushtojë fushëveprimin e saj, sepse kjo gjë mund të ngushtojë padrejtësisht fushëveprimin e mbrojtjes së Aktit. Ligjet ekzistuese, si ligjet për mbrojtjen e të dhënave dhe ato kundër diskriminimit, duhet gjithashtu të përdoren për të trajtuar sfidat që përbën përdorimi i inteligjencës artificiale për të drejtat themelore, pasi këto ligje zbatohen si në internet ashtu edhe jashtë tij.

OPINIONI 7.2 I FRA-SË

Komisioni Evropian në udhëzuesin e tij për zbatimin e aktit duhet të sigurojë që ofruesit e shërbimeve digjitale të interpretojnë dhe zbatojnë detyrimet e parashikuara në Aktin “Për shërbimet digjitale” në mënyrë që të respektohen të drejtat themelore, për shembull në lidhje me rrezikun e heqjes së tepërt të përmbajtjes dhe në lidhje me lirinë e shprehjes.

Akti referencë “Për shërbimet digjitale” u miratua në vitin 2022. Ky miratim shënnoi një hap të rëndësishëm drejt një mjedisi më të sigurt në internet, në të cilin të drejtat themelore të përdoruesve mbrohen më mirë. Në të njëjtën kohë, disa organizata të shoqërisë civile (OShC) kanë shprehur shqetësime për hapësirën që u është lënë ofruesve të shërbimeve në internet për ta zbatuar atë në një mënyrë që mund të dëmtojë të drejtat themelore, kryesisht lirinë e shprehjes, duke i dhënë përparësi kujdesit dhe duke hequr përmbajtje më shumë se ç’duhet për të shmangur sanksionet negative.

Akti “Për shërbimet digjitale” përmban shumë dispozita që synojnë të rritin mbrojtjen e të drejtave themelore. Akti kërkon që platformat shumë të mëdha në internet të vlerësojnë rregullisht rreziqet për të drejtat themelore dhe të propozojnë masa zbutëse. Akti gjithashtu parashikon qasje më të mirë në të dhënat që mbajnë ose krijojnë platformat në internet. Kjo gjë do t’u bëjë të mundur organeve mbikëqyrëse dhe kërkuesve të pavarur e të verifikuar të vlerësojnë rreziqet ndaj të drejtave themelore.



OPINIONI 7.3 I FRA-SË

Shtetet Anëtare të BE-së duhet ta përputhin legjislacionin e tyre për ruajtjen e të dhënave me jurisprudencën e GjDBE-së për të shmangur ruajtjen e përgjithshme dhe pa dallim të të dhënave nga ofruesit e shërbimeve të telekomunikacionit. Përveç kësaj, Shtetet Anëtare duhet të garantojnë që ligji i tyre i brendshëm të përmbajë kontrolle të rrepta të proporcionalitetit si dhe garancitë e duhura procedurale për të garantuar me efektshmëri të drejtat themelore për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Në vitin 2022, qeveritë e vendeve punuan për nisma ligjore që synonin përforcimin e qasjes së autoriteteve ligjzbatuese tek të dhënat për zbulimin dhe hetimin e veprimtarive kriminale. Direktiva “Për ruajtjen e të dhënave” u anulua në vitin 2014 dhe Gjykata e Drejtësisë e BE-së (GjDBE) që atëherë ka ripohuar në disa vendime të saj paligjshmërinë e ruajtjes së përgjithshme dhe pa dallim të të dhënave. Sidoqoftë, disa Shtete Anëtare të BE-së ende po propozojnë reforma në legjislacionin e tyre të brendshëm për të lejuar ruajtjen e të dhënave në pajtim me vendimet e GjDBE-së. Nga disa OShC dhe autoritete publike në disa Shtete Anëtare pati ankesa kundër dispozitave të projektligjeve ose të ligjeve të miratuara që nuk ishin në pajtim me kërkesat e GjDBE-së.



Në vitin 2022, qeveritë dhe autoritetet e forcave të rendit qëndruan të interesuara për përdorimin e teknologjive për qëllime mbikëqyrjeje dhe për qasjen në të dhënat që mund të identifikojnë veprimtaritë kriminale dhe kërcënimet për sigurinë. Edhe pse të ndryshme për nga konteksti dhe nga natyra, këto teknologji mund të kenë ndikim serioz në të drejtat themelore të individëve.

Nga njëra anë, zbulimet e Pegasus-it nxorën në dritë se disa autoritete publike dhe qeveri mund të përdorin "spyware" pa objektiv specifik dhe në shkallë të gjerë. Nga ana tjetër, interesi i vazhdueshëm nga qeveritë dhe autoritetet e forcave të rendit për zgjerimin dhe legalizimin e teknologjive të mbikëqyrjes që mbështeten në mbledhjen e gjithanshme të të dhënave personale sensitive (si njohja e fytyrës) përbën shqetësim për organet publike dhe OShC-të për ligjshmërinë, nevojën dhe proporcionalitetin e këtyre teknologjive. Në disa Shtete Anëtare, OShC-të, autoritetet publike dhe gjykatat tërhoqën vëmendjen për rreziqet ndaj të drejtave themelore që lidhen me teknologjitë e përparuara të mbikëqyrjes dhe sidomos me përdorimin e kamerave të mbikëqyrjes në hapësirat publike.



OPINIONI 7.4 I FRA-SË

Institucionet e BE-së dhe Shtetet Anëtare duhet të garantojnë që çdo nismë ligjore e propozuar për të rritur sigurinë e individëve të respektojë të drejtat themelore. Në mënyrë të veçantë, ligjet e miratuara për të përdorur të dhënat biometrike ose teknologjitë për njohjen e fytyrës duhet të sigurojnë që të zbatohen garancitë e përshtatshme për të mbrojtur të drejtat për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë.

Këto masa garantuese duhet të parashikohen me ligj, të jenë të nevojshme dhe proporcionale. Mekanizma të pavarur mbikëqyrjeje duhet të garantojnë që zbatimi i këtyre masave të kontrollohet rregullisht. Individët duhet të kenë mundësinë të ankohen për këto masa kur ato nuk janë në pajtim me të drejtat themelore dhe duhet të kenë qasje në zgjidhje ligjore efektive.

8

TË DREJTAT E FËMIJËS

Numri i fëmijëve në rrezik varfërie dhe përjashtimi shoqëror vazhdoi të rritet në vitin 2022. Kostoja e lartë e energjisë dhe inflacioni në rritje e rritën barrën për ekonomitë familjare në të cilat familjet me fëmijë e kanë të vështirë të mbulojnë nevojat bazë. Shtetet Anëtare të BE-së po përpiqen të trajtojnë nevojat e fëmijëve dhe familjeve që janë në vështirësi, edhe nëpërmjet Garancisë Evropiane për Fëmijën.

Bashkë me mbërritjen e fëmijëve që kanë ikur nga Ukraina, mbërritja e fëmijëve të tjerë shtetas të vendeve të treta që kërkonin azil vazhdoi të rritet. Si rezultat, disa Shtete Anëtare e patën të vështirë të ofronin kushtet bazë të pritjes dhe disa shtete vazhduan t'i mbanin fëmijët të ndaluar në kontekstin e migracionit. Komisioni Evropian bëri propozime të ndryshme legjislative për të drejtat e viktimave. Kështu, Shtetet Anëtare morën hapa të shumtë legjislative për mbrojtjen e fëmijëve të përfshirë në sistemet e drejtësisë si viktimë, si dëshmitarë ose kur janë në konflikt me ligjin.



OPINIONI 8.1 I FRA-SË

Komisioni Evropian duhet të orientojë dhe mbështetë Shtetet Anëtare të BE-së për zbatimin e planeve të tyre kombëtare në kuadrin e Garancisë Evropiane për Fëmijën. Këtu duhet të përfshihen financimet e BE-së si fondi ESF+, asistenca teknike dhe ndarja e praktikave të mira. Zbatimi i planeve kombëtare duhet të kontrollohet nëpërmjet Gjashtëmujorit Evropian dhe rezultatet përkatëse të monitorimit të përfshihen në rekomandime specifike për secilin vend.

Shtetet Anëtare të BE-së duhet të vazhdojnë dhe të rritin, aty ku është e nevojshme, veprimtaritë në proces për të trajtuar ndikimin e krizës së energjisë dhe të inflacionit të lartë mbi familjet e varfra, duke u përqendruar në mënyrë të veçantë te personat më të cenusshëm, për shembull te familjet me një prind të vetëm, familjet rome dhe ato emigrante. Masat e përkohshme, nëse janë të suksesshme, mund të integrohen në politikat sociale, madje edhe në zbatimin e planeve kombëtare të Garancisë Evropiane për Fëmijën.

Thuajse një në katër fëmijë jeton në rrezik varfërie ose përjashtimi shoqëror në BE (24.4%). Ka pasur më parë një prirje në rënie e kësaj shifre, me 22.2 % të fëmijëve në rrezik varfërie ose përjashtimi shoqëror në vitin 2019, por pandemia e COVID-19 e ndërpreu këtë prirje. Norma e lartë e vazhdueshme e varfërisë së fëmijëve është e lidhur me detyrimet e Shteteve Anëtare të BE-së për të garantuar të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve (neni 24 i Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore dhe neni 3 i Traktatit për Bashkimin Evropian) dhe me objektivat e politikave sociale të BE-së (neni 151 i Traktatit për Funkzionimin e Bashkimit Evropian).

Zbatimi i Garancisë Evropiane për Fëmijën nisi në vitin 2022. Të gjitha Shtetet Anëtare caktuan koordinatorët kombëtarë dhe 18 Shtete Anëtare zhvilluan planet kombëtare të veprimit. Koordinatorët kombëtarë kanë nivele të ndryshme autoriteti brenda administratave kombëtare. Përveç kësaj, planet e veprimit ndryshojnë për nga natyra dhe përmbajtja, por shumë Shtete Anëtare kanë caktuar të paktën 5 % të fondeve nga Fondi Social Evropian Plus (ESF+) për të zbatuar veprimet në kuadrin e Garancisë Evropiane për Fëmijën.

Në kontekstin e Gjashtëmujorit Evropian 2022, tetë Shtete Anëtare morën rekomandime specifike sipas situatës së tyre, të lidhura me arsimin dhe kujdesin për fëmijërinë e hershme.

Kriza e energjisë dhe normat e larta të inflacionit në vitin 2022 rritën numrin e fëmijëve që jetojnë në ekonomi familjare të varfra. Disa Shtete Anëtare kanë marrë masa me politika sociale për ta trajtuar situatën, si rritja e përfitimeve për fëmijët, dhënia e pagesave në një herë të vetme ose ndihma për faturat e ngrohjes.

Fëmijët migrantë dhe azilkërkues vazhduan të vinin në Evropë, shpesh në rrethana të rrezikshme. Numri i fëmijëve që kanë kërkuar azil u rrit në mënyrë domethënëse në vitin 2022, me një total prej 222 100, nga të cilët 39 520 mbërritën të pashoqëruar. Fëmijët migrantë kanë të drejtë të mbrohen sipas Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas Kartës së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe sipas legjislacionit tjetër të BE-së, si Direktiva "Për kushtet e pritjes".

Shumë Shtete Anëtare të BE-së kanë pasur vështirësi të ofronin kushte të përshtatshme pritjeje, madje edhe strehim, sipas kërkesave të Direktivës "Për kushtet e pritjes". Disa vende i mbajtën të ndaluar fëmijët me familjet e tyre ose fëmijët e pashoqëruar, kryesisht në kontekstin e rikthimit ose për qëllime identifikimi ose vlerësimi të moshës. Organet evropiane dhe ndërkombëtare ngritën shqetësime serioze për kushtet e këqija të pritjes në BE. Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin rriti mbështetjen e saj operacionale për Shtetet Anëtare.

Në vitin 2022, 18 Shtete Anëtare ranë dakord për një mekanizëm solidariteti me bazë vullnetare për të mbështetur risistemimin e azilkërkuesve në Mesdhe dhe përgjatë rrugës së Atlantikut perëndimor. Që nga fillimi i risistemimit në vitin 2020 e deri në dhjetor 2022 u risistemuan nga Greqia rreth 5040 persona, ndër të cilët ishin 1021 fëmijë me familjet e tyre dhe 1313 fëmijë të pashoqëruar.

Sipas kërkimeve të FRA-së, kujdestaria e fëmijëve të pashoqëruar, një garanci kryesore në Direktivën "Për kushtet e pritjes" (neni 24) dhe në Direktivën "Për procedurat e azilit" (neni 25), ka pësuar evolucion në vitet e fundit nëpërmjet zhvillimeve në legjislacionet kombëtare. Megjithatë, mbeten ende disa sfida: mandati i kujdestarit shpesh kufizohet te përfaqësimi ligjor, caktimi i kujdestarit mund të zgjasë më shumë se një muaj, kujdestarëve mund t'u caktohet një numër i madh fëmijësh dhe nuk ka trajnim të mjaftueshëm për kujdestarët e caktuar rishtas.



OPINIONI 8.2 I FRA-SË

Shtetet Anëtare të BE-së duhet të kushtojnë burime të mjaftueshme nga BE-ja dhe burime kombëtare për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve azilkërkues dhe migrantë, qofshin këta me familjet e tyre apo të pashoqëruar. Ndarja e burimeve të mjaftueshme duhet të garantojë që kushtet e pritjes të respektojnë standardet minimale të parashikuara në Direktivën "Për kushtet e pritjes", sidomos për ofrimin e strehimit të përshtatshëm dhe shmangien e ndalimit nëpërmjet zbatimit të alternativave ndaj ndalimit. Në veçanti, Shtetet Anëtare duhet të rritin përpjekjet e tyre për të caktuar kujdestarë të trajnuar dhe të pajisur me burime për çdo fëmijë që mbërrin i pashoqëruar në BE dhe të sigurojnë që ata të ndjekin shkollën.

OPINIONI 8.3 I FRA-SË

Bashkë-ligjvënësit e BE-së duhet të sigurojnë që të drejtat ekzistuese dhe garancitë procedurale për fëmijët që janë viktimë të krimit, të mbuluara tashmë nga Direktiva "Për të drejtat e viktimave", nga Direktiva "Për trafikimin e qenieve njerëzore" dhe nga Direktiva "Për abuzimin seksual me fëmijë" të forcohen nëpërmjet propozimeve të Komisionit Evropian dhe përtej tyre.

Shtetet Anëtare të BE-së duhet të forcojnë përpjekjet e tyre për të siguruar që fëmijët në konflikt me ligjin të kenë qasje në një proces gjyqësor të drejtë, me të gjitha garancitë e parashikuara në Direktivën "Për garancitë procedurale". Këtu përfshihet edhe ofrimi i trajnimeve të detyrueshme shumëdisiplinore për të gjithë profesionistët e drejtësisë dhe profesionistët e shërbimeve sociale të përfshirë.

Komisioni Evropian ka paraqitur nisma të ndryshme legjislative që do të kenë ndikim të madh të të drejtat e fëmijëve të përfshirë në sistemet e drejtësisë si viktimë ose dëshmitarë të krimeve: rregulla të reja për të parandaluar dhe luftuar abuzimin seksual me fëmijë në internet, një direktivë të re për dhunën në familje dhe rishikimin e Direktivës "Për trafikimin e qenieve njerëzore". Shumë Shtete Anëtare të BE-së miratuan legjislacion të ri në fushën e të miturve viktimë, duke u përqendruar te reagimi ndaj krimeve seksuale, përfshirë ata në internet; duke përmirësuar garancitë procedurale dhe duke hequr datat e parashkrimit.

Neni 48 i Kartës së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore parashikon garanci të rëndësishme për prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për t'u mbrojtur. Neni 24 kërkon që konsiderata parësore t'i jepet interesit më të lartë të fëmijës.

Direktiva "Për garancitë procedurale" përcakton një numër garancish për të miturit në konflikt me ligjin. Studimet e FRA-së për zbatimin e saj në praktikë nxjerrin në pah një sërë sfidash, si mungesa e informacionit të përshtatur për fëmijët, dobësi në zbatimin e vlerësimeve individuale, rrjedhje e informacioneve private në medie dhe raportime të keqtrajtitimit ose sjelljes së dhunshme nga ana e policisë. Studimet tregojnë gjithashtu se trajnimet janë të disponueshme deri në njëfarë shkalle, por vetëm me baza vullnetare.



9

QASJA TE DREJTËSIA: TË DREJTAT E VIKTIMAVE DHE PAVARËSIA E GJYQËSORIT

Në vitin 2022, ka pasur pak përmirësim në fushën e të drejtave të viktimave, sidomos sa i takon mbrojtjes së viktimave me nevoja specifike. Sa i takon grave si viktima të dhunës me bazë gjinore ka pasur zhvillime të mëdha legjislative dhe politike në BE dhe në disa Shtete Anëtare të BE-së, në nivel kombëtar. Këtu hyn botimi i një propozimi të BE-së për një direktivë të re për të luftuar dhunën kundër gruas dhe dhunën në familje.

Mbeten ende shqetësime serioze për sundimin e ligjit dhe pavarësinë e gjyqësorit në disa Shtete Anëtare të BE-së. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian shpalli vendimin e saj të parë për mekanizmin e përgjithshëm të kushtëzimit. Ky mekanizëm është një regjim i përgjithshëm kushtëzimi që mbron buxhetin e BE-së në rast se Shtetet Anëtare shkelin parimet e sundimit të ligjit që lidhen me zbatimin e buxhetit të BE-së. Vendimi konfirmoi pajtueshmërinë e mekanizmit me legjislacionin parësor të BE-së.



Neni 22 i Direktivës së BE-së "Për të drejtat e viktimave" dhe deklaramimet e saj parashikojnë të drejtën e viktimës për një vlerësim individual të nevojave. Për rrjedhojë, Shtetet Anëtare janë të detyruara të vlerësojnë në mënyrë individuale nevojat specifike të viktimave dhe të përcaktojnë nëse ato përfitojnë nga masat e posaçme gjatë procedimeve penale dhe në ç'masë përfitojnë prej tyre.

Në vitin 2022, pak Shtete Anëtare miratuan masa praktike për të lehtësuar identifikimin e viktimave me nevoja speciale. Këto masa përfshinin orientime për trajtimin e grupeve të ndryshme të viktimave të cenushme dhe një fushatë informimi të përqendruar te grupet specifike të viktimave.

Megjithatë, sfidat mbeten. Vlerësimi i Direktivës "Për të drejtat e viktimave" nga Komisioni Evropian identifikoi mangësi të ndryshme të lidhura me mbrojtjen e nevojave individuale të viktimave. Këto mangësi prekin cilësinë e trajtimit që viktimat merrnin pas një krimi dhe gjatë procedimeve penale. Vlerësimi i Komisionit i lidh këto mangësi me mungesën e njohurive për nevojat specifike ndër profesionistët, gjë që nga ana tjetër mund të shkaktojë konsideratën e pamjaftueshme që u jepet viktimave. Vlerësimi nënvizoi mungesën e udhëzimeve specifike për kryerjen e vlerësimeve individuale, mungesën e ndërgjegjësimit ndër profesionistët për rëndësinë e vlerësimit dhe mungesën e trajnimit të profesionistëve.



OPINIONI 9.1 I FRA-SË

Shtetet Anëtare të BE-së duhet të garantojnë që viktimat të marrin një vlerësim individual për të identifikuar nevojat specifike për mbrojtje. Ky vlerësim duhet të përcaktojë nevojat e tyre për masa mbrojtjeje të veçanta gjatë procedimeve penale, për shkak të cenusshmërisë së tyre të veçantë. Përveç kësaj, Shtetet Anëtare inkurajohen të japin udhëzime dhe trajnime specifike për profesionistët në mënyrë që të mbështetin të drejtën e viktimës për vlerësim individual.

OPINIONI 9.2 I FRA-SË

Të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së që e kanë ratifikuar Konventën e Stambollit duhet të kriminalizojnë dhunën seksuale duke përdorur përkufizimet e përdhunimit dhe të formave të tjera të dhunës seksuale me bazë pëlqimi. Shtetet Anëtare duhet gjithashtu të garantojnë që aktet e qëllimshme seksuale të kryera pa pëlqimin e viktimës të hetohen, përndiqen dhe penalizohen me efektivitet.

OPINIONI 9.3 I FRA-SË

BE-ja dhe Shtetet e saj Anëtare inkurajohen të rritin më tej përpjekjet dhe bashkëpunimin për të ruajtur dhe forcuar pavarësinë e gjyqësorit si një përbërës thelbësor i sundimit të ligjit dhe i besimit të ndërsjellë. Në këtë kontekst, Shtetet Anëtare inkurajohen të vijojnë me shpejtësi me rekomandimet dhe masat. Këtu përfshihen edhe masat e miratuara në kontekstin e mekanizmit evropian të sundimit të ligjit dhe në kuadrin e mekanizmit të BE-së për kushtëzimin.

Deri në fund të vitit 2022, të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së kishin nënshkruar Konventën e Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave" (Konventa e Stambollit), edhe pse gjashtë prej tyre ende duhet ta ratifikojnë atë. Sipas nenit 36 të konventës, Shteteve Palë u kërkohet të kriminalizojnë aktet me natyrë seksuale që ndodhin pa pëlqimin e njërit prej personave të përfshirë. Kriminalizimi i akteve seksuale të bazuara në përkufizimet me bazë pëlqimi kërkohet edhe nga nenet 3 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas interpretimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo është në pajtim me konceptet bashkëkohore të dhunës seksuale, të cilat nuk mbështeten te forca ose karakteristikat e ngjashme.

Miratimi i përkufizimeve me bazë pëlqimi i dhunës seksuale në Shtetet Anëtare të BE-së po ecën përpara. Në vitin 2022, në pak Shtete Anëtare u miratuan ligje të reja dhe propozime të reja legjislative në këtë kuadër.

Një gjyqësor i pavarur është guri i themelit të sundimit të ligjit dhe i aksesit të drejtësisë (neni 19 i Traktatit të Bashkimit Evropian, neni 67 (pika 4) i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe neni 47 i Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore).

Sfidat në fushën e drejtësisë vazhduan në disa Shtete Anëtare të BE-së, për shembull sa i takon perceptimit të pavarësisë së gjyqësorit në Shtetet Anëtare të BE-së, siç e tregon Tabela Vlerësuese për Drejtësinë e BE-së për vitin 2022.

Komisioni Evropian nxori raportin e tretë vjetor për sundimin e ligjit në vitin 2022. Tema e sistemeve të drejtësisë dhe pavarësia e tyre ishte një nga katër fushat qendrore të mbuluara nga raporti. Edhe pse mirëpret reformat e rëndësishme për të forcuar pavarësinë e gjyqësorit, raporti përmend shqetësime strukturore që qëndrojnë në pak Shtete Anëtare sa i përket pavarësisë së gjyqësorit.

Gjatë këtij viti u pa edhe miratimi i vendimit të parë zbatues në kuadrin e Rregullores "Për kushtëzimin e përgjithshëm". Ky vendim imponon masa për mbrojtjen e buxhetit kundër pasojave të shkeljeve të parimeve të sundimit të ligjit. Vendimi ka të bëjë edhe me prokurimet publike, me efektshmërinë e veprimit të organit të akuzës dhe me luftën kundër korrupsionit në Hungari.



10

ZHVILLIMET NË ZBATIMIN E KONVENTËS PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Ligjberësi në BE ndërmori veprime për të ofruar paga minimale të drejta edhe për personat me aftësi të kufizuar. Parlamenti Evropian bëri propozime të reja për të lehtësuar zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (CRPD) në BE, duke përfshirë ligjin e zgjedhjeve në BE, para zgjedhjeve evropiane të vitit 2024. Megjithatë, përdorimi i fondeve të BE-së për institucionalizimin mbetet shqetësues.

Në nivel kombëtar, mbeten ende dallime të thella midis nivelit të pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuar në tregun e punës dhe nivelit të pjesëmarrjes së personave të tjerë në tregun e punës dhe në sistemin arsimor. Shtetet Anëtare të BE-së kanë bërë progres të kufizuar në ofrimin e asistencës përkatëse dhe në dhënien fund të qasjeve të veçuara.

Zbatimi i direktivave të BE-së për aksesueshmërinë dhe i programeve kombëtare për aksesueshmërinë ka ecur përpara. Por, Shtetet Anëtare nuk kanë respektuar afatet e transpozimit dhe progresi mbetet i pabarabartë. Shtetet kanë bërë përpjekje të mëdha për të mirëpritur personat e ikur nga Ukraina, duke përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuar. Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (Komiteti për CRPD-në) kërkoi përgjigje nga BE-ja për një gamë të gjerë pyetjesh, nëpërmjet një liste që i dërgoi Komisionit Evropian.

Kuadri kombëtar suedez i monitorimit filloi punën, kësaj Shtetet Anëtare dhe BE-ja tani kanë kuadrin e kërkuar nga neni 33, pika 2, i CRPD-së.

Neni 27 i CRPD-së kërkon që personat me aftësi të kufizuar duhet të jenë të aftë të nxjerrin jetesën me një punë të zgjedhur ose të pranuar lirisht prej tyre në një treg dhe mjedis pune të hapur, gjithëpërfshirës dhe të arritshëm nga personat me aftësi të kufizuar. Komiteti i CRPD-së e sqaroi këtë detyrim në Komentin e Përgjithshëm nr. 8 (2022), edhe duke shënuar se punësimi i mbrojtur, me një përjashtim të kufizuar, nuk është i pranueshëm si masë për të nxitur punësimin e personave me aftësi të kufizuar në kuadrin e CRPD-së.

Statistikat e BE-së dhe ato kombëtare tregojnë se hendeku i punësimit për personat me aftësi të kufizuar ende qëndron dhe tani është në shkallën e 23.1 pikë përqindje. Përveç kësaj, pavarësisht reformave që synojnë përmirësimin e pjesëmarrjes në tregun e hapur të punës, punësimi i veçuar vazhdon të mbështetet dhe personave me aftësi të kufizuar u jepet mbështetje e pamjaftueshme për të garantuar që ata të kenë qasje në tregun e punës. Kjo ndodh veçanërisht me gratë dhe personat e moshuar. Direktiva "Për pagën minimale" do të ndihmojë në përmirësimin e situatës së personave me aftësi të kufizuar, por nuk do të ndryshojë vetvetiu praktikën kombëtare të punësimit.



OPINIONI 10.1 I FRA-SË

Shtetet Anëtare të BE-së duhet të marrin veprime të efektshme për të trajtuar hendekun e punësimit për personat me aftësi të kufizuar me masa gjithëpërfshirëse dhe të shënjestruara në të gjithë sektorët e ekonomisë, për të arritur përfshirjen e plotë në punësim. Komisioni Evropian duhet të monitorojë zbatimin e Direktivës së re "Për pagën minimale", edhe sa i takon personave me aftësi të kufizuar. Në këtë aspekt, Shtetet Anëtare duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë personave me aftësi të kufizuar, duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga Komiteti i CRPD-së.

Shtetet Anëtare duhet të eliminojnë gradualisht punësimin e mbrojtur, në pajtim me CRPD-në. Ata duhet të marrin masa efektive për të integruar individët që punojnë në tregun e hapur të punës. Në marrjen e këtyre masave, ata duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë nxitjes së mundësive të punësimit për gratë dhe të moshuarit me aftësi të kufizuar.

OPINIONI 10.2 I FRA-SË

Për të lehtësuar kalimin nga arsimi drejt tregut të punës, Shtetet Anëtare të BE-së duhet t'u japin asistencë të mjaftueshme studentëve me aftësi të kufizuara, në të gjitha nivelet e arsimit. Ata duhet të sigurojnë që të gjitha mjediset e mësimi në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë të jenë gjithëpërfshirëse dhe plotësisht të arritshme.

Neni 24 i CRPD-së njih të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për arsim dhe kërkon realizimin e kësaj të drejte pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta. Shteteve Palë të konventës u kërkohet të garantojnë sistem arsimor gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Megjithatë, personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të hasin pengesa të mëdha në qasjen te sistemet arsimore. Ata kanë më pak gjasë të përfundojnë arsimin e mesëm dhe të marrin diploma që të jenë të dobishme për pjesëmarrjen e plotë në tregun e punës; ata kanë më pak gjasë edhe të regjistrohen në arsimin e lartë ose ta përfundojnë atë. Ka gjithashtu vështirësi për të kaluar nga arsimi në tregun e punës.

Ndërtesat dhe aspektet e tjera të mjedisit të mësimi nuk janë mjaftueshëm të arritshme për personat me aftësi të kufizuara. Shtetet Anëtare vazhdojnë të përdorin mjedise mësimore të ndara, në vend që të investojnë në një sistem arsimor të rregullt të plotë dhe gjithëpërfshirës.



OPINIONI 10.3 I FRA-SË

Shtetet Anëtare të BE-së duhet të zbatojnë plotësisht legjislacionin ekzistues të BE-së në fushën e aftësisë së kufizuara, duke përfshirë Aktin Evropian për Aksesueshmërinë dhe Direktivën "Për aksesueshmërinë e rrjetit të internetit". Në fushat si transporti publik dhe infrastruktura, Shtetet Anëtare duhet të zbatojnë plotësisht detyrimet që kanë në kuadrin e nenit 9 të CRPD-së. Komisioni Evropian duhet të konsiderojë propozime për zgjerimin e direktivave për aksesueshmërinë në fusha të tjera.

Neni 9 i CRPD-së kërkon që personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje të plotë në shoqëri, në mjedisin fizik, në transport, në informacion dhe komunikime, duke përfshirë sistemet dhe teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, dhe në strukturat dhe shërbimet e hapura për publikun ose që ofrohen për publikun, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale. BE-ja ka miratuar direktivat përkatëse në këtë fushë, si Akti Evropian për Aksesueshmërinë dhe Direktiva "Për aksesueshmërinë e rrjetit të internetit" dhe është bërë progres në përfshirjen e tyre në legjislacionet e brendshme dhe në zbatimin e tyre. Megjithatë, një numër i madh Shtetesh Anëtare nuk kanë respektuar afatet për përfshirjen e Aktit Evropian për Aksesueshmërinë në legjislacionin e brendshëm dhe ende nevojitet të bëhet progres në vitet që vijnë për të siguruar zbatimin e plotë.

Një vlerësim i bërë nga Komisioni Evropian gjeti edhe sfida të mëdha që mbeten për të përfshirë Direktivën "Për aksesueshmërinë e rrjetit të internetit" në legjislacionin e brendshëm. Këto janë të dukshme edhe në raportet kombëtare. Pavarësisht njëfarë progresi, mbeten sfida edhe në fusha të tjera të aksesueshmërisë, si aksesueshmëria më e gjerë në infrastruktura dhe në fushën e transportit publik. BE-ja ka miratuar legjislacion në disa fusha.





Viti 2022 solli njëkohësisht progres dhe pengesa në fushën e mbrojtjes së të drejtave themelore. *Fundamental Rights Report 2023* (Raporti për të drejtat themelore – 2023) i FRA-së merr në shqyrtim zhvillimet më të mëdha në BE nga janari deri në dhjetor 2022 dhe ravijëzon opinionet e FRA-së për to. Duke shprehur arritjet dhe fushat që ende mbeten shqetësuese, raporti hedh dritë mbi çështjet kryesore që i japin formë debatit për të drejtat themelore në BE.



Fokusi i këtij viti hedh vështrimin mbi pasojat e luftës në Ukrainë për të drejtat themelore të BE-së. Kapitujt e tjerë trajtojnë Kartën e BE-së për të Drejtat Themelore; barazinë dhe mosdiskriminimin; racizmin, ksenofobinë dhe intolerancën e lidhur me to; integrimin e romëve; azilin dhe migracionin; shoqërinë e informacionit, privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave; të drejtat e fëmijës; qasjen te drejtësia dhe zhvillimet në zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.



PËRKRAHJA DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TUAJA THEMELORE NË BASHKIMIN EVROPIAN —

Për *Fundamental Rights Report 2023* (Raportin e plotë për të drejtat themelore të FRA-së – 2023) – shih <https://fra.europa.eu/sq/publication/2023/fundamental-rights-report-2023>

Shih edhe botimet e FRA-së që lidhen me të:

- FRA (2023), *Raporti për të drejtat themelore 2023 – opinionet e FRA-së*, Luksemburg, Zyra e Botimeve, <https://fra.europa.eu/sq/publication/2023/fundamental-rights-report-2023-fra-opinions> (i disponueshëm në të gjitha 24 gjuhët e BE-së)
- FRA (2023), *Fundamental rights implications for the EU of the war in Ukraine* (Pasojat e luftës në Ukrainë në të drejtat themelore për BE-në), Luksemburg, Zyra e Botimeve, <https://fra.europa.eu/sq/publication/2023/frr-2023-focus-war-in-ukraine> (të disponueshëm në anglisht dhe frëngjisht)

Raportet e mëparshme vjetore të FRA-së për të drejtat themelore janë të disponueshme në [faqen zyrtare](#) të FRA-së (të disponueshëm në anglisht dhe frëngjisht).

INFORMACIONE TË MËTEJSHME



FRA – AGJENCIA E BASHKIMIT EVROPIAN PËR TË DREJTAT THEMELORE

Schwarzenbergplatz 11 – 1040 Vienna – Austria

T +43 158030-0 – F +43 158030-699

fra.europa.eu

facebook.com/fundamentalrights

linkedin.com/company/eu-fundamental-rights-agency

twitter.com/EURightsAgency



Publications Office
of the European Union